91	**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**	**53,300**	**1,000**	**0**	**1,000**	**54,300**	**54,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**55,000**	**54,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**55,500**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	53,300	1,000	0	1,000	54,300	54,000	1,000	0	1,000	55,000	54,500	1,000	0	1,000	55,500
92	**Instituti i Studimeve te Krimeve te Komunizmit**	**34,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**35,500**	**34,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**35,500**	**34,500**	**1,000**	**0**	**1,000**	**35,500**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	34,500	1,000	0	1,000	35,500	34,500	1,000	0	1,000	35,500	34,500	1,000	0	1,000	35,500
95	**Autoriteti për te Drejten e Informimit**	**57,000**	**2,000**	**0**	**2,000**	**59,000**	**58,000**	**2,000**	**0**	**2,000**	**60,000**	**58,500**	**2,000**	**0**	**2,000**	**60,500**
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	57,000	2,000	0	2,000	59,000	58,000	2,000	0	2,000	60,000	58,500	2,000	0	2,000	60,500
TOTALI		**237,552,470**	**57,145,000**	**34,418,000**	**91,563,000**	**329,115,470**	**244,693,698**	**58,525,000**	**37,560,000**	**96,085,000**	**340,778,698**	**255,834,713**	**61,925,000**	**39,560,000**	**101,485,000**	**357,319,713**

VENDIM
Nr. 118, datë 13.3.2019

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË, ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE FONDACIONIT "FUNDJAVË NDRYSHE", SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË NR. 109, ME EMËRTIM "SHA RIPARIM ARTILERIE ", E PËRBËRË NGA DISA SIPËRFAQE, TRUALL FUNKSIONAL DHE OBJEKTE, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 43 169 M2

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me ofertë të pakërkuar, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe fondacionit "Fundjavë Ndryshe", si qiramarrës, për pasurinë nr. 109, me emërtim "SHA Riparim Artilerie", e përbërë nga disa sipërfaqe, truall funksional dhe objekte, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 43 169 (dyzet e tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m^2, me afat 20 (njëzet) vjet.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe fondacioni "Fundjavë Ndryshe" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr. _____ Rep.
Nr. _____ Kol.

DRAFT-KONTRATË QIRAJE
Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata
Lidhur

Në Tiranë, sot më datë _____të muajit _____ të vitit 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), u paraqitën para meje noterit_____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar me autorizim të Ministrit, nr. _____ nga Z/Znj. _____ me detyrë _____, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, i datëlindjes __/__/_____, banues në _____, me shtetësi shqiptare i/e pajisur me letër njoftimin nr. _____, që më poshtë do të quhet "**QIRADHËNËSI"**

DHE

Fondacioni "Fundjavë Ndryshe", me seli qendrore në Gjykatën e Tiranës, në datën 1.12.2015 me vendimin nr. 534, me adresë, _____, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja me NIPT: L61315453U, përfaqësuar nga Z/Znj._____, i biri/bija i/e _____, i datëlindjes __/__/_____, lindur në _____ dhe banues në _____, me shtetësi _____, identifikuar me letër njoftimin personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet "**QIRAMARRËSI**".

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mbështetur në vendimin nr. 760, datë 19.12.2018 të Këshillit të Ministrave dhe në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", të ndryshuar, në zbatim të vendimit nr. ____, datë __.__.____ të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 Euro/kontrata, me ofertë të pa kërkuar", ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si Qiradhënës dhe Fondacionit "Fundjavë Ndryshe" si Qiramarrës, për pasurinë "nr. 109, me emërtim "sh.a. Riparim

Artilerie" dhe disa sipërfaqeve truall funksional dhe objekte, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 43 169 m^2, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, si dhe kërkesës së Fondacionit "Fundjavë Ndryshe", së bashku me "Qiramarrësin", palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë shtetërore: "nr. 109, me emërtim "sh.a. Riparim Artilerie" dhe disa sipërfaqeve truall funksional dhe objekte, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 43 169 m^2" në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, sipas genplanit dhe dokumentit të ZVRPP Tiranë, bashkëlidhur kontratës.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për ngritjen e një kompleksi administrativ, arsimor dhe shërbimesh pa shpërblim (falas), për ndihmën dhe rehabilitimin e njerëzve në nevojë.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhe 20 (njëzetë) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1"Qiradhënësi", nëpërmjet _____, si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet proces-verbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Qiramarrësit".

4.3 "Qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, _____, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 "Qiradhënësi" është i detyruar të garantojë "Qiramarrësin" për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 "Qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 "Qiramarrësi" ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 "Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3 "Qiramarrësi" detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

5.4 "Qiramarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 "Qiramarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 "Qiramarrësi" detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 "Qiramarrësi", Fondacioni "Fundjavë Ndryshe" me projektin të cilin do e emërtojë "Qendra e Solidaritetit" pas marrjes në dorëzim të pasurisë shtetërore dhe pajisjen me lejet përkatëse sipas legjislacionit shqiptar, planifikon një investim me vlerë totale prej 105 901 560 lekë, i cili do të përfundojë brenda 5 viteve nga data e lidhjes së kontratës.

Sipas plan-biznesit të paraqitur, ky investim do të realizohet si vijon:

Faza e parë e investimit: investimi i fazës së parë do të jetë në vlerën rreth 40 400 000 lekë dhe do të realizohet brenda 24 muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse. Kjo vlerë investimi do të konsistojë realizimin e punimeve për normalizimin e rrugëve hyrëse dhe rrugëve të brendshme, prishjen e godinave, fillimin e punimeve për ndërtimin dhe montimin e objekteve si: Zyrat e fondacionit, kapanoni i cili do të shërbejë si magazinë dhe shkolla profesionale.

Faza e dytë e investimit do të jetë në vlerën rreth 39 400 000 lekë dhe do të realizohet brenda 12 muajve nga përfundimi i fazës së parë të investimit. Në ketë fazë do të përfundojnë punimet e ndërtimit dhe montimin e kapanonit, shkollës dhe parkimi.

Faza e tretë e investimit do të jetë në vlerën rreth 26 101 560 lekë dhe do të realizohet brenda afatit 5-vjeç të realizimit të gjithë investimit të marrë përsipër në këtë sipërmarrje. Gjatë kësaj faze do të përfundojnë punimet për trotuaret, lulishtet dhe terrenet sportive. Gjithashtu do të përfundojë mobilimi i shkollës profesionale dhe pajisja e saj me inventar ekonomik dhe me pajisje informatike.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të investimeve të parashikuara transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

5.8 "Qiramarrësi", sipas parashikimit për punësimin të shprehur sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim që, pas përfundimit të fazës së parë të investimit në objekt do të jenë të punësuar 13 punonjës. Gjate fazës së dytë të investimit do të punësohen 10 punonjës të rinj, dhe në përfundim të kësaj faze numri i të punësuar do të jetë 23 punonjës me kohë të plotë dhe të siguruar pranë institucioneve përkatëse. Me përfundimin e fazës së tretë të investimit numri i të punësuarve në pasurinë e marrë me qira do të jetë 50 punonjës me kohë të plotë dhe të siguruar pranë institucioneve përkatëse.

Në vijim të zhvillimit të kontratës numri i të punësuarve nuk do të jetë më pak se 50, me kohë të plotë dhe të siguruar pranë institucioneve përkatëse.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

"Qiramarrësi" detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

5.9 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedisore nga organet kompetente.

5.10 "Qiramarrësi" detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.7 dhe 5.8 të kësaj kontrate.

5.11 "Qiramarrësi" detyrohet të paraqesë te "Qiradhënësi" në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.12 "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.13 "Qiramarrësi", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. "Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Qiramarrësi".

5.14 Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.15 "Qiramarrësit" nuk i lejohet, që pronën e dhënë me qira ta japë me nën qira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.16 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që, të pajiset me lejet

ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.17 "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

5.18 Shitja e kuotave të aksioneve apo ndryshimi i ortakëve të shoqërisë qiramarrëse, do të kryhet vetëm pas miratimit paraprak të "qiradhënësit".

Neni 6
Pagesa e qirasë

6.1"Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "Qiradhënësit" detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro. Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës "Qiramarrësi" ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën 2 118 031 lekë, sipas faturës së lëshuar nga "Qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.7 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, "Qiramarrësi" do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Qiradhënësit" sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7
Penalitetet

7.1 Në rastin kur "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, "Qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "Qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8
zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve.

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore.

c) kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate.

d) kur 'Qiramarrësi" ndryshon destinacionin për të cilën është lidhur kontrata.

e) kur prona nevojitet për interes publik.

f) kur prona kalon në procedurë privatizimi.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të "Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse "Qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9
Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "Qiramarrësi", sipas pikave 5.7, 5.8 dhe 5.9 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, _____, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të fondacionit shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët, "Qiramarrësi" dhe _____, janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "Forcë Madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të Forcës Madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhe do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10
Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë Plan biznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe proces verbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "Qiramarrësit".

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi ju lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë te nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI
Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
Përfaqësuar nga

QIRAMARRËSI
Fondacioni "Fundjavë Ndryshe"
Përfaqësuar nga

VENDIM
Nr. 119, datë 13.3.2019

PËR NJË SHTESË FONDI NGA FONDI REZERVË I BUXHETIT TË SHTETIT, MIRATUAR PËR VITIN 2019, DHE RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 18, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në buxhetin e vitit 2019, në programin "Arsimi universitar", në artikullin 604, i shtohet fondi prej 1 700 000 000 (një miliard e shtatëqind milionë) lekësh.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të përballohet duke pakësuar fondet, si më poshtë vijon:

a) 380 000 000 (treqind e tetëdhjetë milionë) lekë në shpenzimet korrente në programin "Arsimi bazë", të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

b) 300 000 000 (treqind milionë) lekë në shpenzimet korrente në artikullin 606, në programin "Përkujdesi social", të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

c) 1 020 000 000 (një miliard e njëzet milionë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 121, datë 13.3.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 760, DATË 19.12.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, TË PRONËS ME NR. 98, ME EMËRTIMIN "GRUP DEPO (ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5011)", DHE TË DISA SIPËRFAQEVE, TRUALL FUNKSIONAL DHE OBJEKTE, TË PRONËS NR. 109, ME EMËRTIMIN "SHA RIPARIM ARTILERIE", ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Mbrojtjes , Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 760, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimin ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të disa sipërfaqeve, truall funksional dhe objekte, të pronës nr. 109, me emërtimin "Sh.a. Riparim artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë.";

b) Në pikën 1 hiqen fjalët "... të pronës me emërtimin "Grup Depo (ish- Reparti Ushtarak nr. 5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe ...";

c) Në pikat 2 dhe 3, fjalët "... pronat e përcaktuara ..." zëvendësohen me "... trualli funksional dhe objektet e pronës nr. 109, të përcaktuara ...";

ç) Në pikën 4, fjala "... pronave ..." zëvendësohet me "... truallit funksional dhe objekteve të pronës nr. 109...".

2. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Ministria e Mbrojtjes, të pronës nr. 98, me emërtimin "Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)".

3. Prona nr. 98, me emërtimin "Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)", i kthehet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 122, datë 13.3.2019

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARE, PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP), për vitin 2019, në shumën 378 360 000 (treqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PASQYRA NR. 1
PLANI I SHPENZIMEVE TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARE PËR VITIN 2019

Të ardhura	Në mijë lekë	Shpenzime	Në mijë lekë
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike	160 000	Shpenzime personeli	114 049
Të ardhura nga pagesa për frekuencat	132 000	Shpenzime për sigurimet shoqërore e shëndetësore	14 751
Të ardhura nga pagesa për numeracionin	26 000	Shpenzime për materiale	8 730
Të ardhura nga pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit të numrit	20 160	Shpenzime për shërbime	148 914
Të ardhura nga pagesa për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar	8 500	Shpenzime për investime	91 916
Të ardhura nga pagesa për domain	8 000		
Të ardhura nga pagesa të tjera	700		
Të ardhura nga agjenti tatimor	23 000		
Total i të ardhurave	**378 360**	**Totali i shpenzimeve**	**378 360**

VENDIM
Nr. 123, datë 13.3.2019

PËR DHËNIEN E LEJES SË POSAÇME "TRANS ADRIATIC PIPELINE", AG, ZVICËR, PËR NDËRTIMIN DHE OPERIMIN E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (TAP) NË TERRITORIN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pikat 3.4, paragrafi "ii", e 3.5; 5, pikat 5.1, 5.2 e 5.3; dhe 45, të "Marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)", ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Shoqëria *Trans Adriatic Pipeline*, AG (TAP AG) gjatë operimit të gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) zbaton kërkesat e përcaktuara nga ERE me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, të bordit të komisionerëve të ERE-s, "Për amendimin e vendimit të bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 27, datë 1.3.2013, "Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP-AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline", për marrjen në konsideratë të opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Evropian (C(2013) 2949" (vendimi për përjashtim i ERE-s").

2. Pas marrjes së lejes së posaçme, në përputhje me MQP-në dhe legjislacionin në fuqi, investitori i projektit ka përgjegjësinë të mirëmbajë gazsjellësin TAP operativ gjatë të gjithë vlefshmërisë së lejes së posaçme.

II. PËRKUFIZIME

Përkufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, në marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës (MQP), ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, të ndryshuar, dhe në vendimin nr. 713, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror", zbatohen, për sa janë të aplikueshme në kontekstin e MQP-së, nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë vendim.

Ndërkohë, përkufizimet e mëposhtme kanë kuptimet, si më poshtë vijon:

1. "Mbajtësi i lejes së posaçme", investitori i projektit;

2. "Lejet dhe licencat ekzistuese", të gjitha lejet dhe licencat e çfarëdo lloji natyre, të lëshuara për investitorin e projektit nga shteti, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, lidhur me ndërmarrjen e cilësdo veprimtarie të projektit për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës shqiptare dhe të sistemit të gazsjellësit në përgjithësi;

3. "Pikë hyrje dhe/ose dalje", pika/t në infrastrukturën shqiptare, në territorin shqiptar, që do të shërbejnë për marrjen ose futjen dhe transportimin e gazit natyror në sistemin e gazsjellësit.

III. DHËNIA E LEJES SË POSAÇME

1. Investitorit të projektit i jepet kjo leje e posaçme për ndërtimin dhe operimin e gazsjellësit Trans Adriatik dhe të gjithë infrastrukturës shqiptare, që shërben për qëllimet e transmetimit të gazit natyror dhe lidhjes së tij me sistemet e vendeve fqinje, sipas kushteve dhe termave të MQP-së. Sistemi i gazsjellësit është projektuar të funksionojë me një kapacitet transporti që mund të rritet nga kapaciteti fillestar, prej 10 miliardë metrash kub gaz (BCM) në vit, deri në 20 miliardë metra kub gaz (BCM) në vit.

2. Në vijim të MQP-së dhe në përputhje me lejen e posaçme dhe leje të tjera të posaçme vijuese, mbajtësi i lejes së posaçme nuk është i detyruar të themelojë si dhe të veprojë nëpërmjet një shoqërie në Republikën e Shqipërisë, sipas pikave 2, 4, 5, 6, shkronja "a", dhe 7, të vendimit nr. 713, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave, dhe mbajtësit të lejes së posaçme nuk i imponohen kritere të mëtejshme lidhur me statusin e vet të veprimtarisë së biznesit, sipas legjislacionit shqiptar.

3. Kjo leje e posaçme është e zbatueshme lidhur me realizimin, ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës shqiptare, në përputhje me skemën e miratuar me vendimin nr. 1, datë 8.4.2014, të Këshillit Kombëtar të Territorit, "Për miratimin e lejes zhvillimore komplekse për gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)", të ndryshuar, duke përfshirë edhe:

a) ndërtimin e një pike dalëse/hyrëse në afërsi të stacionit të kompresorëve në Topojë, Fier (SKO-3), në përputhje me vendimin nr. 233, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e marrëveshjes së angazhimit për zhvillimin e tregut të gazit dhe të marrëveshjes për përfitimet vendase, të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë, e cila vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline, AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik.";

b) një tjetër pikë dalëse/hyrëse, e parashikuar në seksionin 4.7.7, të vendimit të përjashtimit të ERE-s, duke i dhënë përparësi zonës së Kuçovës, qarkut Berat, si dhe çdo pike hyrëse dhe dalëse shtesë, në përputhje me seksionin 4.7.8, të vendimit të përjashtimit të ERE-s, duke përfshirë mundësinë e ofruar nga stacioni matës/kompresor i Bilishtit, Korçë (SKO-2);

4. Kjo leje e posaçme lëshohet për një periudhë 30-vjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Afati i lejes mund të shtyhet në përputhje me dispozitat e MQP-së;

5. MQP-ja konsiderohet si marrëveshja e referuar në pikën 2, të nenit 11, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe në pikën 18, të vendimit nr. 713, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave, që lidhet ndërmjet investitorit të projektit dhe palës shtetërore ose autoritetit të pavarur, lidhur me lejen e posaçme.

6. Çdo kërkesë tjetër, sipas dispozitave ligjore të sipërpërmendura, konsiderohet e përmbushur plotësisht. MQP-ja ka hyrë në fuqi më 11.11.2014 (data efektive), sipas përcaktimit të pikës 2.2, të MQP-së.

IV. TRANSFERIMI I LEJES SË POSAÇME

1. Në përputhje me nenin 45.2, të MQP-së, leja e posaçme, e lëshuar në kuadër të këtij vendimi, mund t'i transferohet nga investitori i projektit, si mbajtësi i lejes së posaçme, çdo pale të tretë, që do të ndërmarrë ato veprimtari të autorizuara të projektit, të cilat lidhen me përdorimin e pjesës shqiptare të infrastrukturës, por vetëm në masën që ky transferim është në përputhje me MQP-në dhe nuk sjell mospërputhje me legjislacionin shqiptar mbi konkurrencën. Leja mund t'i transferohet përsëri investitorit të projektit, sipas zgjedhjes së këtij të fundit.

2. Në përputhje me nenin 45.2, të MQP-së, për qëllimet e transferimit të lejes së posaçme, investitori i projektit, në funksionin e mbajtësit të lejes së posaçme, duhet të marrë, paraprakisht, miratimin e autoriteteve shtetërore, bazuar në kërkesën e investitorit të projektit, miratim, i cili nuk mund të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme dhe që duhet shqyrtuar brenda një periudhe 20-ditore.

V. RINOVIMI I LEJES SË POSAÇME

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose çdo pasardhës ligjor i saj në sektorin e hidrokarbureve, përpara përfundimit të afatit të lejes së posaçme (përfshirë të gjitha lejet e posaçme vijuese, të lëshuara në përputhje me nenin 5.3, të MQP-së), pas miratimit me vendim nga Këshilli i Ministrave, i lëshon investitorit të projektit lejen e posaçme vijuese, me të njëjtat terma, kushte dhe kohëzgjatje prej 30 vitesh, pa nevojën e veprimeve nga ana e palëve shtetërore ose autoritetit të pavarur. Dispozitat e pikave 18, shkronja "c", dhe 27, të vendimit nr. 713, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave, (përfshirë të gjitha ndryshimet që mund të ndërmerren në këtë vendim), lidhur me rinovimin e lejes së posaçme, nuk zbatohen për investitorin e projektit.

2. Rinovimi i lejes së posaçme, sipas pikës 1, më lart, nuk kryhet nëse investitori i projektit, jo më vonë se dy vjet përpara përfundimit të afatit të lejes së posaçme dhe në përputhje me dispozitat e MQP-së, i kërkon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë apo pasardhësit të saj ndërprerjen përfundimtare të veprimtarive të projektit.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, shoqëria TAP AG ekzekuton pagesën prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, të përcaktuar sipas shkronjave "a" dhe "b", të pikës 23, të vendimit nr. 713, datë 25.8.2010 të Këshillit të Ministrave.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 124, datë 13.3.2019

PËR PROCEDURAT E TRANSFERIMIT TË FONDIT GRANT "PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE NË KONVIKTET E STUDENTEVE" TË BASHKISË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi në dispozicion të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në masën 300 000 000 (treqind milionë) lekë, në llogarinë ekonomike 604, të programit buxhetor 09450, "Arsimi i Lartë", i trashëguar për vitin 2019, të përdoret me destinacion përmirësimin e kushteve në konviktet e studentëve të Bashkisë Tiranë.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, pas miratimit nga Komiteti i Ndihmës Shtetërore, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të transferohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë te përfituesi, ndërmarrja/et e trajtimit të studentëve, me pronar Bashkinë Tiranë, si transfertë në llogarinë e përfituesit në bankën e nivelit të dytë.

3. Transferimi i fondeve të realizohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pas konfirmimit nga Bashkia Tiranë të ndërmarrjes/eve të trajtimit të studentëve, Tiranë, (përfituesi), dhe numrit të llogarisë bankare të tij/tyre në bankën e nivelit të dytë përkatëse.

4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Bashkia Tiranë të monitorojnë mbarëvajtjen e punimeve për realizimin e projektit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, nëpërmjet një grupi ekspertësh me përfaqësues nga të dyja institucionet.

5. Përbërja dhe detyrat e grupit të ekspertëve përcaktohen me urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë,

Bashkia Tiranë dhe ndërmarrja/et e trajtimit të studentëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 125, datë 13.3.2019

PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI PARCELAT E OBJEKTEVE TË LEGALIZUARA DHE KOMPENSIMIN FINANCIAR TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN PREJ TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 15/1, dhe të shkronjës "ç", të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të nenit 163, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 10 e 24, të ligjit nr.133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", si dhe të shkronjës "ç", të nenit 4, të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995, "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit të së drejtës së pronësisë në favor të subjekteve përfituese për 681 (gjashtëqind e tetëdhjetë e një) parcela ndërtimore të objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Numri i parcelave ndërtimore, për të cilat miratohet kalimi i pronësisë sipas qarqeve, është, si më poshtë vijon:

a) Për qarkun Berat (ZVRPP Berat, Kuçovë, Lushnjë), numri i parcelave ndërtimore është 27 (njëzet e shtatë), me sipërfaqe të përgjithshme 5 759 (pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) m².

b) Për qarkun Elbasan (ZVRPP Elbasan, Peqin, Librazhd, Gramsh), numri i parcelave ndërtimore është 179 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë), me sipërfaqe të përgjithshme 50 462 (pesëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) m².

c) Për qarkun Tiranë (ZVRPP Tiranë dhe Kavajë), numri i parcelave ndërtimore është 142 (njëqind e dyzet e dy), me sipërfaqe të përgjithshme 36 442 (tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e dy) m².

ç) Për qarkun Fier (ZVRPP Fier, Lushnjë), numri i parcelave ndërtimore është 78 (shtatëdhjetë e tetë), me sipërfaqe të përgjithshme 30 250 (tridhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) m².

d) Për qarkun Shkodër (ZVRPP Shkodër), numri i parcelave ndërtimore është 11 (njëmbëdhjetë), me sipërfaqe të përgjithshme 3 753 (tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre) m².

dh) Për qarkun Vlorë (ZVRPP Vlorë dhe Sarandë), numri i parcelave ndërtimore është 131 (njëqind e tridhjetë e një), me sipërfaqe të përgjithshme 38 721 (tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzetë e një) m².

e) Për qarkun Gjirokastër (ZVRPP Gjirokastër, Përmet), numri i parcelave ndërtimore është 46 (dyzet e gjashtë), me sipërfaqe të përgjithshme 9 201 (nëntë mijë e dyqind e një) m².

ë) Për qarkun Lezhë (ZVRPP Lezhë), numri i parcelave ndërtimore është 4 (katër), me sipërfaqe të përgjithshme 1 067 (një mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) m².

f) Për qarkun Kukës (ZVRPP Kukës, Tropojë), numri i parcelave ndërtimore është 26 (njëzet e gjashtë), me sipërfaqe të përgjithshme 7 251 (shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë e një) m².

g) Për qarkun Korçë (ZVRPP Korçë, Pogradec), numri i parcelave ndërtimore është 21 (njëzet e një), me sipërfaqe të përgjithshme 4 717 (katër mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) m².

gj) Për qarkun Durrës (ZVRPP Durrës), numri i parcelave ndërtimore është 13 (trembëdhjetë), me sipërfaqe të përgjithshme 3 182 (tre mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) m².

3. Masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet e legalizuara, referuar kartelave të pasurive sipas ZVRPP-ve, është 11 866,63

(njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e tre) m² dhe vlera totale e kompensimit financiar është 49 033 353,21 (dyzet e nëntë milionë e tridhjetë e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e tre presje njëzet e një) lekë.

4. Vlera e miratuar e kompensimit financiar për numrat rendorë dhe pasuritë e mëposhtme vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, sipas kushteve vijuese:

a) Për numrin rendor nr.389, pasuria nr.141/26, në zonën kadastrale 3550, pas miratimit nga kreditori të vënies në dispozicion të shumës, sipas pikës 12, të vendimit nr.465, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objekteve informale".

b) Për numrin rendor nr.502, pasuria nr.13/67, në zonën kadastrale 8642, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të shkakut të kufizimit, sipas pikës 15, të vendimit nr.465, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objekteve informale".

5. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Berat, Elbasan, Peqin, Librazhd, Gramsh, Durrës, Tiranë, Fier, Lushnjë, Shkodër, Korçë, Pogradec, Lezhë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, Përmet, Kavajë dhe Kukës të regjistrojnë, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kalimin e së drejtës së pronësisë së parcelave ndërtimore dhe hipotekën ligjore mbi to, në përputhje me përcaktimet e pikave 15 e 16, të vendimit nr.1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, si dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara".

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Shtojca

LISTA EMERORE E PERFITUESVE TE KALIMIT TE SE DREJTES SE PRONESISE DHE MASA E VLERA E SHPERBLIMIT PER SUBJEKTET QE KOMPENSOHEN

DREJTORIA E ALUIZNI-t Berat

QARKU Berat, ZVRPP Kuçovë, ZONA KADASTRALE 1943

Nr. rendor	Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar								Kompensimi i Pronarëve							
	Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit: Numer	Leja e legalizimit: Date	Gjendja juridike (pronësia)	Pjesa takuese në parcelë (m²)	Sipërfaqja për kalim pronësie (m²)	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lekë)	Sekulori i Veçantë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16 (10x54*15)	17
1	AGIM	SHAHIN	MUÇA	10002413	23.05.2018	SHTET		121								
QARKU Berat, ZVRPP Berat , ZONA KADASTRALE 3165																
2	BATJAR	KADRI	HAJDËRANJ	10002332	24.04.2018	SHTET		322								
3	SHKËLQIM	SADUSH	PUTRO	10002306	20.03.2018	SHTET		160								
4	SHKËLQIM	SADUSH	PUTRO	10002307	20.03.2018	SHTET		440								
QARKU Berat, ZVRPP Berat , ZONA KADASTRALE 8501																
5	PELLUMB	SHEFIT	KALEMASI	10002330	24.04.2018	SHTET		208.9								
	MAJLINDA	NAZMI	KALEMASI													
6	AJET	QAZIM	VAVLA	10002392	21.05.2018	SHTET		302								
	ANA	LEKO	VAVLA													
7	JULIAN	MYFTAR	VREKO	10002367	30.04.2018	SHTET		300								
8	SKËNDER	FASLLI	BOBOÇI	10002368	30.04.2018	SHTET		91								
	MIMOZA	ASQERI	BOBOÇI													
9	KRISTO	SPIRO	HAXHISTASA	10002420	04.05.2018	SHTET		286								
10	RUKIJE	HAMDI	CINGO	10002281	28.03.2018	SHTET		183								
11	SOSE	FERIT	KAJO	10002376	30.04.2018	SHTET		122								
12	BASHKIM	MYSLIM	ARAPI	10002346	26.04.2018	SHTET		171.3								
13	PRANVERA	SAMEDIN	HAXHIALIU	10002305	30.03.2018	SHTET		292.7								
14	PËRPARIM	PAJO	ÇUNI	10002326	23.04.2018	SHTET		185.2								
15	ANDREA	AMET	SARAÇI	10002299	29.03.2018	SHTET		162								
16	ESTREF	NOVRUS	BEQARAJ	10002315	19.04.2018	SHTET		500								
	XHEVAIR	NOVRUS	BEQARAJ													
17	GAZMENT	YZEDIN	SPAHIU	10002355	26.04.2018	SHTET		24.9								
18	SHYQYRI	BASHKIM	KËRPICA	10002251	23.03.2018	SHTET		12.8								
19	ARTJAN	BESTAR	VOKOPOLA	10002313	18.04.2018	SHTET		26								
QARKU FIER, ZVRPP LUSHNJE , ZONA KADASTRALE 8571																
20	MERUSHE	HASLLAN	ZANI	10001006	16.02.2017	Shtetërore (188m²) E të tretëve (122m²)		310	XHEMIL	ESTREF	KURTI	24/84	122	9709	1184498	
	SILVANA	ABEDIN	LIÇAJ (ZANI)													
	DELVINA	ABEDIN	ZANI													
	GJONI	ABEDIN	ZANI													
QARKU Berat, ZVRPP Berat , ZONA KADASTRALE 2525																
21	SOTIR	VANGJEL	GRAMATIKO	10002374	30.04.2018	SHTET		110								
QARKU Berat, ZVRPP Berat , ZONA KADASTRALE 1217																
22	JANI	SHAHIN	GJIKA	10002325	23.04.2018	SHTET		51.2								
23	JANI	SHAHIN	GJIKA	10002324	23.04.2018	SHTET		57.6								
QARKU Berat, ZVRPP Berat , ZONA KADASTRALE 3555																
24	BURAN	BESNIK	MALASI	10002453	29.05.2018	SHTET		780								
QARKU Berat, ZVRPP Kuçovë, ZONA KADASTRALE 2310																
25	ARMANDO	BARJAM	DYRMA	10002333	24.04.2018	SHTET		120								
26	VERA	BALIL	LINO	10002347	26.04.2018	SHTET		119.3								
27	KRENAR	FEJZI	SHKURTI	10002365	27.04.2018	SHTET		300								
DREJTORIA E ALUIZNI-t ELBASAN																
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 2124																
28	BAJRAM	QAMIL	PLAKU	2579038	27/04/2018	SHTETERORE		324.9								
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3965																
29	KADRI	HYSNI	BAKU	9060502	12/9/2017	SHTETERORE		45.6								
	FATJON	KADRI	BAKU													
30	ARTAN	MUSA	HALILI	2579594	24/07/2018	SHTETERORE		1500.6								
QARKU ELBASAN , ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 8527																
31	ROLAND	REXHEP	BUZRA	9595841	10/10/2016	Pronar		167.1	HYSEN	IBRAHIM	NEZIRI	149/51	167.1	12,764	2,132,864.4	
32	ROLAND	REXHEP	BUZRA	9595841	10/10/2016	Pronar		96.9	ADRIAN	DILAVER	SEJDINI	149/3/2	96.9	12,764	1,236,831.6	
									BEKIM	RIFAT	KADIU					
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8521																
33	ROLAND	SHAMO	ARANI	2578776	16/04/2018	SHTET		51.2								
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8522																
34	HAMDI	BEHEXHET	LAZI	2579059	30/04/2018	SHTETERORE		9.5								
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8523																
35	BARDHYL	NEZIR	GJELI	2578908	21/04/2018	SHTETERORE		42.7								
	ISMETE	QANI	GJELI													
	EDMOND	SHEFKI	BEJKOLLI													
	ZAMIRA	RAIT	BEJKOLLI													
	DHIMITËR	JOSIF	ÇAKALLI													
	VITORE	KOL	ÇAKALLI													
	DELINA	HYSNI	KAMAMI													

QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8525																
36	ZEQIR	ISMAIL	SLLAMI	809048	9/5/2017	SHTETERORE		74.3								
37	ASHKI	MEÇAN	TRIMI	2579062	30/04/2018	SHTETERORE		96								
38	AGIM	EMIN	PISHA	2578847	19/04/2018	SHTETERORE		180.5								
	ALMA	TEFIK	PISHA													
39	MIT-HAT	MYRTEZA	BALLA	1030560	3/12/2016	SHTETERORE		478.6								
40	FADIL	MAHMUT	DEDA	869857	14/09/2017	SHTETERORE		158.6								
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8526																
41	XHEVAT	SHEFQET	CIRONGU	2578768	16/04/2018	SHTET		367.5								
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 8522																
12			QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS , ZONA KADASTRALE 2724 (MORINË)	1	282.6
13			QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS , ZONA KADASTRALE 3425 (SHTIQËN)	2	719
14			QARKU KUKËS, ZVRPP KUKËS , ZONA KADASTRALE 1328	2	600
TOTALI DREJTORIA KUKES				**26**	**7251**
1	**9**	**TIRANE JUG**	QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE , ZONA KADASTRALE 8180	1	300.9
TOTALI DREJTORIA TIRANE JUG				**1**	**301**

1	10	FIER	QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 3358 SH. MARINAS ,ZVRPP FIER	6	6982
2			QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 8533 ZVRPP FIER	9	3721.5
3			QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 8532 ZVRPP FIER	17	3914.9
4			QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 3981 ZVRPP FIER	6	1883
5			QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 8534 ZVRPP FIER	27	8476
6			QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 3031 ZVRPP FIER	3	1410
7			QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 1351 FSHATI CAKRAN ZVRPP FIER	6	2395
8			QARKU FIER , ZONA KADASTRALE 1634 fshati Frakull e Madhe ZVRPP FIER	1	590
TOTALI DREJTORIA FIER				**75**	**29372**
1	11	DURRES	QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 1925, ZVRPP DURRES	1	400
2			QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 3385, ZVRPP DURRES	1	200
3			QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 3542, ZVRPP DURRES	2	161
4			QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 8518, ZVRPP DURRES	1	19
5			QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 8516, ZVRPP DURRES	4	1122
6			QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 8514, ZVRPP DURRES	1	17
7			QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 8511, ZVRPP DURRES	2	932
8			QARKU DURRES , ZONA KADASTRALE 3852, ZVRPP DURRES	1	331.42
TOTALI DREJTORIA DURRES				**13**	**3182**
1	12	GJIROKASTER	Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 1476	2	259
2			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 1936	1	430
3			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 1234	2	723
4			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 3833	2	144
5			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 8541	4	539.5
6			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 8542	2	401.6
7			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 8543	4	699
8			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 2392	4	1175
9			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 2277	1	425
10			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 1592	1	3.4
11			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 2867	1	377
12			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 1311	2	144
13			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 2444	5	1517
14			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Permet/ Zona kadastrale 2794	2	134
15			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Permet/ Zona kadastrale 3701	4	409.4
16			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 1053	2	212.5
17			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 1970	3	660
18			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 2956	2	517.6
19			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 2174	1	310
20			Qarku Gjirokaster/ Bashkia Gjirokaster/ Zona kadastrale 2646	1	120
TOTALI DREJTORIA GJIROKASTER				**46**	**9201**
1	13	SARANDE	Qarku Vlore/ Bashkia Saranda/ Zona kadastrale 8641,8642	61	18379.8
2			Qarku Vlore/ Bashkia Saranda/ Zona kadastrale 8642	19	5673.5
3			Qarku Vlore/ Bashkia Saranda/ Zona kadastrale 3832	1	500
4			Qarku Vlore/ Bashkia Saranda/ Zona kadastrale 2264	3	731.6
TOTALI DREJTORIA SARANDE				**84**	**25285**
1	14	TIRANA RURALE	Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2380	3	771
2			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3550	4	1045.6
3			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1604	2	610.5
4			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1605	2	583.5
5			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3866	16	4607.7
6			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1032	2	658.8
7			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3714	2	568.5
8			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2655	2	436.9
9			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2953	1	231.6
10			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2704	1	350
11			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2105	3	1183.6
12			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3064	1	262.2
13			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2951	1	370
14			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2953	3	1333.8
15			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1078	1	288.6
16			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1498	4	1511.7
17			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2753	1	288
18			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1978	1	419.4
19			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2776	1	309.4
20			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2119	5	1392.9
21			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2460	1	240.9
22			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1549	6	1703.4
23			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3426	1	200
24			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2947	1	399.6
25			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1906	3	889.8
26			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1978	2	630.9
27			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3417	1	432.6
28			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3125	1	140
29			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3116	1	177.6
30			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1315	2	858.2
31			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2952	1	294.3
32			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3321	1	299.2
33			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2953	2	913.8
34			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3865	1	85.4
35			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2900	1	333.3

36			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1622	1	261.9
37			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2679	1	181.6
38			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2752	1	300.3
39			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1377	1	388.8
40			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3976	2	571.2
41			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2953	1	291.9
TOTALI DREJTORIA TIRANA RURALE				**88**	**26818**
1			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2066	8	2096.7
2			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 1066	4	971.2
3	**15**	**TIRANA KAMEZ VORE**	Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 3992	5	1744.3
4			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2884	11	2770.3
5			Qarku Tirane/ Bashkia Tirane/ Zona kadastrale 2596	1	431.1
TOTALI DREJTORIA KAMEZ VORE				**29**	**8014**
1			Qarku Vlore/ Bashkia Vlore/ Zona kadastrale 1060	6	1533
2			Qarku Vlore/ Bashkia Vlore/ Zona kadastrale 2955	4	1059
3			Qarku Vlore/ Bashkia Vlore/ Zona kadastrale 8602	6	2130
4			Qarku Vlore/ Bashkia Vlore/ Zona kadastrale 8603	6	818
5	**16**	**VLORE**	Qarku Vlore/ Bashkia Vlore/ Zona kadastrale 8604	12	3461.7
6			Qarku Vlore/ Bashkia Vlore/ Zona kadastrale 8601	5	1446
7			Qarku Vlore/ Bashkia Vlore/ Zona kadastrale 8605	6	1779
8			Qarku Vlore/ Bashkia Vlore/ Zona kadastrale 1952	1	717
9			Qarku Vlore/ Bashkia Vlore/ Zona kadastrale 1569	1	492
TOTALI DREJTORIA VLORE				**47**	**13436**
TOTALI				**681**	**190807**

VENDIM
Nr. 126, datë 13.3.2019

PËR MBYLLJEN E NDËRMARRJES SHTETËRORE "QENDRA NDËRKOMBËTARE E KULTURËS "ARBNORI""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e ndërmarrjes shtetërore "Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori"".

2. Ngarkohet Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori" të likuidojë detyrimet ndaj të tretëve.

3. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 8.8.1991, "Për krijimin e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës", dhe nr. 384, datë 6.3.2009, "Për mbylljen e përkohshme të veprimtarisë së ndërmarrjes shtetërore "Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori"", shfuqizohen.

4. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 128, datë 13.3.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË, TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 3, dhe 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, i miratuar në buxhetin e vitit 2019 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shuma prej:

a) 495 000 000 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë milionë) lekësh, në zërin "Transfertë në buxhetet familjare" (llogaria ekonomike 606), të përdoret për:

- rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve blegtorale e të peshkimit dhe uljen e kostove të prodhimit, nëpërmjet pagesave të kafshëve të matrikulluara, për dorëzimin e qumështit, si dhe për açuge dhe sardele të peshkuara;

- mbështetjen e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në zonat rurale;

- mbështetjen për Fermën Didaktike Eksperimentale, të Universitetit Bujqësor të Tiranës, për trajnimin dhe transferimin e njohurive në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

b) 125 000 000 (njëqind e njëzet e pesë milionë) lekësh, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të huaj" për projektin "Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të ullirit" (llogaria ekonomike 231), të përdoret për shtimin e sipërfaqeve të mbjella me ullinj, përmirësimin e mekanizimit dhe rritjen e kapaciteteve të prodhimit të vajit të ullirit.

2. Masat e mbështetjes dhe të financimit të jenë, si më poshtë vijon:

a) Për tufën bazë të matrikulluar, për fermat me jo më pak se 100 krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 1 000 (një mijë) lekë/krerë.

b) Dorëzim qumështi lëndë e parë, në vlerën 10 lekë për litër në pikat e përpunimit, për fermat me jo më pak se 10 krerë lopë kundrejt faturës tatimore të shitjes, por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë për subjekt.

c) Mbarështim i bletarisë me 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 zgjoje, por masa e financimit të jetë jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt.

ç) Mbështetje ndaj anijeve të peshkimit me flamur shqiptar, në vlerën 20 (njëzet) lekë/kg për açuge dhe/ose sardele të peshkuara. Pagesa të kryhet kundrejt sasive të tregtuara në stabilimentet shqiptare vetëm për qëllime përpunimi të këtyre produkteve, të vërtetuara me fatura tatimore dhe certifikatë zënieje. Në rastin kur anijet janë në pronësi ose të marra me qira nga stabilimentet e përpunimit të peshkut, pagesa të kryhet kundrejt sasive të verifikuara me certifikatë zënieje dhe/ose:

- faturave të shitjes së produkteve të përpunuara për në tregun vendas;

- të deklaratës doganore për eksportin e prodhimeve të përpunuara.

d) Mbjellje e ullinjve në vlerën 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit, dhe në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale. Kur kultivari është autokton masa e financimit shtohet me 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

Sipërfaqja e mbjellë me ullinj për fermerët individualë të jetë jo më pak se 0.2 ha, për grup fermerësh jo më pak se 1 ha, në një bllok të vetëm, për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB) jo më pak se 3 ha. Madhësia e ngastrës të jetë jo më pak se 0.2 ha, kur nuk është në bllok.

Masa e financimit për sipërfaqe të mbjellë të jetë:

- deri në 0.5 ha, me 100% të vlerës për ha;

- mbi 0.5-5 ha (4.5 ha e dytë) të rritet me 25% të vlerës për ha;

- mbi 5.0 -10 ha (5 ha e tretë), të rritet me 50% të vlerës për ha.

Masa e financimit për sipërfaqe të mbjellë, për aplikuesit me status SHBB:

- 3-5 ha, të rritet me 40% të vlerës për ha;

- mbi 5.0 -10 ha (5 ha e dytë), të rritet me 65% të vlerës për ha.

Pagesa për plotësimin e numrit të bimëve në ullishtat e vjetra/degraduara në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë/ha.

dh) Përmirësimi i teknikave të ujitjes, nëpërmjet instalimit të ujitjes me pika në ullinj, jo më shumë se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha.

e) Blerje e makinerive dhe e pajisjeve për vjeljen e ullirit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.

ë) Blerje e makinerive dhe e pajisjeve për prodhimin e vajit të ullirit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt.

f) Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 deri në 10 dhoma, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet të cilët nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.

g) Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet të cilët nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.

3. Mbështetje për Fermën Didaktike Eksperimentale (FDE), të Universitetit Bujqësor

të Tiranës (UBT), në vlerën deri në 125 milionë lekë, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 "Të tjera transferta të brendshme" për financimin e projekteve, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) ekzekuton transferimin e fondit përkatës te UBT-ja, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e këtij fondi.

4. Përfitues të masave mbështetëse, nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, janë fermerët, personat fizikë, juridikë, SHBB-të dhe UBT-ja.

5. Kriteret, procedurat dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

6. Nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2019, të përdoret shuma prej:

a) 83 000 000 (tetëdhjetë e tre milionë) lekësh, për pagesën e vlerës së palikuiduar për subjektet e shpallur fituese nga AZHBR-ja, në zbatim të vendimit nr. 72, datë 7.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018", të ndryshuar;

b) 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë detyrime, për pagesat e normës së interesave bankare për kontratat e lidhura.

7. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1

Nr.	**Emërtimi i projekteve**	**Vlera lekë, deri në:**
1	Ngritja e infrastrukturës së nevojshme në didaktike, trajnuese dhe demonstruese në territorin e FDE-së	11 250 000
2	Sistemimi sipërfaqësor i tokës	1 975 000
3	Rehabilitimi i kanaleve kullues	1 250 000
4	Ndërtimi i burimeve, strukturave të pompimit dhe magjistraleve të sistemit ujitës	27 862 500
5	Fuqizimi i shkallës së mekanizimit në FDE	28 662 500
6	Investimet në sektorin e mbarështimit të kafshëve	37 125 000
7	Rikonstruksioni i kopshtit të lultarisë	2 500 000
8	Krijimi dhe kompletimi i koleksioneve të bimëve drufrutore	12 500 000
10	Ngritja e koleksionit të bimëve barishtore bujqësore	1 875 000
	Shuma	**125 000 000**

VENDIM
Nr. 129, datë 13.3.2019

PËR PROCEDURAT PËR IDENTIFIKIMIN, NDIHMËN E MENJËHERSHME DHE REFERIMIN E FËMIJËVE TË SHFRYTËZUAR EKONOMIKISHT, PËRFSHIRË FËMIJËT NË SITUATË RRUGE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton rregullat dhe procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht në sektorin formal dhe informal, përfshirë fëmijët në situatë rruge, si dhe rolet e përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse.

2. Në kuptim të këtij vendimi termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Fëmijë në situatë rruge", fëmija që varet nga rruga për të jetuar dhe/ose punuar vetëm, me moshatarë ose me familjen.

b) "Punë e ndaluar e fëmijës", çdo punë e kryer nga fëmija, e cila është në kundërshtim me legjislacionin e punës dhe i shkakton dëm apo rrezikon shëndetin, zhvillimin mendor, fizik, shoqëror e social të fëmijës. Këtu përfshihet çdo punë e detyruar, si dhe çdo punë, e cila nuk lejon ose pengon fëmijën të ndjekë arsimin e detyruar.

II. ORGANIZIMI I PUNËS PËR IDENTIFIKIMIN PROAKTIV DHE REFERIMIN E FËMIJËVE TË SHFRYTËZUAR EKONOMIKISHT, PËRFSHIRË FËMIJËT NË SITUATË RRUGE

1. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki është institucioni përgjegjës për organizimin e veprimtarisë lidhur me planifikimin e punës në terren, marrjen e masave për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e rasteve të fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge.

2. Kjo strukturë harton një herë në vit hartën e zonave ku kryhet identifikimi i fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge. Harta përpilohet e përditësohet nga kjo strukturë në këshillim me institucione të tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

3. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki ngre grupet e skuadrave të terrenit, harton dhe miraton planin e punës së strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor dhe skuadrave të terrenit për identifikimin në mënyrë proaktive në terren të fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Në planin e punës përcaktohen sektorët e zonat ku identifikohen fëmijët që shfrytëzohen ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge, ora dhe kohëzgjatja e shërbimit mbi baza një mujore, kontaktet e punonjësit të mbrojtjes së fëmijës, kontaktet e anëtarëve të skuadrave të terrenit, kontaktet e koordinatorit të skuadrave të terrenit dhe personat e kontaktit në drejtorinë vendore të policisë ose në komisariatin e policisë që mbulon zonën.

4. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki shkëmben me drejtorinë vendore të policisë/komisariatin e policisë që mbulon zonën dhe inspektoratin, që mbulon fushën e punës, kontaktet e punonjësit të mbrojtjes së fëmijës dhe të shërbimeve sociale ditore e rezidenciale për fëmijët e shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge, si dhe kontaktet e anëtarëve të skuadrave të terrenit.

5. Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki pajis skuadrat e terrenit me mjetet e punës për realizimin e procedurave të parashikuara në këtë vendim.

6. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki, ngarkon një punonjës të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës, me detyrën e koordinimit dhe të mbikëqyrjes së skuadrave të terrenit.

7. Koordinatori i skuadrave të terrenit garanton zbatimin e planit për identifikimin në terren të fëmijës në nevojë për mbrojtje, si edhe mbledh të dhëna nga skuadra e terrenit për rastet e identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Një kopje e planit të skuadrave të terrenit i dërgohet drejtorisë vendore të policisë.

8. Koordinatori i skuadrave të terrenit i paraqet drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki raportin mujor për veprimtarinë e skuadrave të terrenit dhe rastet e

referuara. Ky raport u shpërndahet edhe drejtorëve të institucioneve të përfshira në këtë proces.

9. Skuadra e terrenit ngrihet në çdo bashki dhe përbëhet nga punonjës socialë të strukturave të mbrojtjes së fëmijës, të përcaktuara në ligjin nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" dhe/ose përfaqësues të organizatave jofitimprurëse. Numri i anëtarëve të secilës skuadër terreni nuk duhet të jetë më shumë se tre.

10. Skuadra e terrenit mbikëqyr zonat që njihen si më të frekuentuara nga fëmijët që shfrytëzohen ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge.

11. Skuadra e terrenit jep ndihmën e parë, plotëson formën e vëzhgimit dhe vlerësimit të shpejtë, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe raporton me shkrim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga momenti i identifikimit të fëmijës në nevojë për mbrojtje te koordinatori i skuadrës së terrenit dhe punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, që mbulon zonën ku është identifikuar rasti sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. PROCEDURAT PËR IDENTIFIKIMIN, NDIHMËN E MENJËHERSHME DHE REFERIMIN E RASTEVE TË SHFRYTËZIMIT EKONOMIK, PËRFSHIRË FËMIJËT NË SITUATË RRUGE

1. Identifikimi proaktiv në terren nga skuadra e terrenit përfshin veprimet, si më poshtë vijon:

a) Vëzhgim i rregullt i fëmijës në mjedisin ku punon ose qëndron në rrugë; kontakt me fëmijët që punojnë nën moshën dhe kushtet e përcaktuara në legjislacionin e punës e me fëmijët dhe familjet e fëmijëve që janë në situatë rruge; vlerësim i shpejtë i situatës së fëmijës për të përcaktuar rrezikun e moshën;

b) Mbledhje e informacionit shtesë për fëmijën dhe gjendjen familjare, përfshirë dhe të rriturit që nuk janë kujdestarë ligjorë, me të cilët fëmija mund të jetë i lidhur;

c) Informim i kujdesshëm i fëmijës dhe të të rriturit të pranishëm për të drejtat e ndihmën që mund t'i ofrohet, për detyrimin ligjor që kanë kujdestarët për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe detyrimet që ka shteti për mbrojtjen e fëmijës që konsiderohet në situatë rreziku.

ç) Informim për alternativat e mundshme të ndihmës dhe dhënia e ndihmës së menjëhershme për ta larguar fëmijën nga situata e rrezikshme e shfrytëzimit ekonomik dhe/ose ajo e rrugës.

d) Referimi i rastit brenda 24 (njëzet e katër) orëve te koordinatori i skuadrës së terrenit dhe te punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, që mbulon zonën ku është identifikuar rasti.

dh) Kryerjen e kallëzimit penal ndaj prindit /kujdestarit apo çdo personi tjetër, në rastet kur fëmija vazhdon të jetë në situatë rruge edhe pas njoftimit, referimit ose ofrimit të alternativave për ndihmë.

2. Kur skuadra e terrenit, përgjatë daljes në terren, identifikon një rast fëmije të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijë në situatë rruge dhe vlerëson se fëmija është në rrezik të lartë e të menjëhershëm, sipas parashikimeve të vendimit nr. 578, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes", e referon menjëherë rastin pranë punonjësit për mbrojtjen e fëmijës.

IV. ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E POLICISË SË SHTETIT

1. Çdo punonjës i policisë, që konstaton një fëmijë në rrezik të lartë dhe të menjëhershëm, merr fëmijën në mbrojtje dhe njofton menjëherë punonjësin e mbrojtjes së fëmijës në territorin ku është fëmija.

2. Skuadrat e terrenit dhe/ose punonjësi i mbrojtjes së fëmijës njoftojnë punonjësin e strukturave të Policisë së Shtetit në territorin ku veprojnë, në rastet kur:

a) fëmija është në situatë rreziku të lartë dhe të menjëhershëm;

b) skuadrat e terrenit organizojnë verifikime ose ndërhyrje në orët e vona të natës;

c) shfaqet qëndresë apo kundërshtim nga prindi, ose person tjetër i rritur, që mbikëqyr punën e fëmijës në sektorin informal ose shoqëron fëmijën në rrugë.

3. Në rastet kur punonjësit e skuadrës së terrenit dhe/ose punonjësi i mbrojtjes së fëmijës kanë bindjen ose dyshimin se ndaj fëmijës është kryer vepër penale, njoftojnë menjëherë me telefon sallën operative të Policisë së Shtetit.

4. Strukturat vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit shkëmbejnë informacion me strukturën përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës në bashki, për kontaktet e punonjësit të Policisë së Shtetit, të ngarkuar për të ndjekur çështjet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

V. ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E INSPEKTORATIT QË MBULON FUSHËN E PUNËS PËR IDENTIFIKIMIN DHE REFERIMIN E FËMIJËVE TË SHFRYTËZUAR EKONOMIKISHT

1. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është struktura kryesore përgjegjëse për identifikimin e rasteve të fëmijëve që shfrytëzohen ekonomikisht.

2. Në rast se gjatë procesit të inspektimit të subjektit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore konstaton se ka fëmijë që kryen/kryejnë punë të ndaluar, raporton menjëherë rastin pranë punonjësit të mbrojtjes së fëmijës në territorin ku është kryer inspektimi, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

3. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor, kryejnë inspektime për identifikimin e rasteve të fëmijëve që kryejnë punë të ndaluar dhe/ose shfrytëzohen ekonomikisht.

4. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore shkëmben me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Policinë e Shtetit të dhënat e mbledhura nga raportimi vjetor i inspektimeve të punës së fëmijëve dhe masat e marra nga ky institucion.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen mekanizmat këshillimorë e koordinues institucionalë dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në nivel qendror dhe vendor, sipas paragrafëve 2, 3 e 4, të nenit 34, të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", Policia e Shtetit dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKS 1
PLANI I PUNËS I VEPRIMTARISË SË SKUADRAVE TË TERRENIT

Plani mujor i lëvizjeve të skuadrave të terrenit

Skuadra e terrenit: **1)**_____
2) _____
3) _____

OJF/Punonjës Social Mbështetës:
_____

Muaji _____
Data:_____
Përgatitur nga: _____

Shembull

Orari	**E hënë**	**E martë**	**E mërkurë**	**E enjte**	**E premte**	**E shtunë**	**E diel**
8.00 – 16.00 Skuadra e Terreni	1	2	3	4	5	6	7
16.00 – 8.00 Ekipi i gatshëm							
8.00 – 16.00 Skuadra e Terrenit	8	9	10	11	12	13	14
16.00 – 8.00 Ekipi i gatshëm							
8.00 – 16.00 Skuadra e Terrenit	15	16	17	18	19	20	21
16.00 – 8.00 Ekipi i gatshëm							

8.00 – 16.00 Skuadra e Terrenit	22	23	24	25	26	27	28
16.00 – 8.00 Ekipi i gatshëm							
8.00 – 16.00 Skuadra e Terrenit	29	30					
16.00 – 8.00 Ekipi i gatshëm							

Kontaktet e personave të përfshirë në kalendar:

1. Emër/Mbiemër, pozicioni, institucioni, nr. i telefonit celular dhe fiks
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____

Aneks 2: FORMA E VËZHGIMIT DHE VLERËSIMIT TË SHPEJTË PËR FËMIJËT NË SITUATË RRUGE

Shënim: Kjo formë është zhvilluar me qëllim që të ndihmojë punonjësit për mbledhjen e informacionit, gjatë procesit të identifikimit dhe vlerësimit të menjëhershëm të fëmijës në situatë rruge dhe të punësuar në sektorin informal, duke synuar një strukturë për mbledhjen dhe pasqyrimin e të dhënave dhe informacionit të marrë gjatë kontaktit me fëmijën dhe familjen në momentin e intervistës.

DATA :_____	**ORA:**	**PUNONJËSIT**

PARA TAKIMIT :

QELLIMI I TAKIMIT/INTERVISTËS: *(p.sh si takim pas marrjes së referimit nga telefoni ose referimi nga të tjerë ose vet identifikimit.)*		

PREZANTIMI: ***(Shembull)*** : Unë quhem _____ dhe punoj për _____. Kolegu/kolegia ime quhet _____ dhe punon si _____. Puna jonë është që të ndihmojmë fëmijët në situata të vështira dhe që kanë ose mund të kenë nevojë për ndihmë. Ne do të bisedojmë bashkë dhe do të përpiqemi të gjejmë një mënyrë për të ndihmuar ty dhe familjen. Unë dëshiroj të të bëj disa pyetje që të kuptoj më mirë për çfarë ke nevojë dhe si mund të ndihmoj. Nëse ti (dhe prindi, nëse ndodhet aty), jeni dakort mund të fillojmë. Ndihu i lirë të më pyesësh si dhe të ndash informacion. (shpjego konfidencialitetin/dhe mënyrën e përdorimi/ shënimet).

VENDNDODHJA:

REFERUAR NGA:

EMRI I FËMIJËS/PRINDËRVE/KUJDESTARËVE/SHOQËRUESVE (nëse ndodhen aty)

MOSHA E FËMIJËS	**Komente të tjera:**
FËMIJË TË TJERË (që ndodhen me fëmijën)	
INFORMACION NGA VËZHGIMI PËR SITUATËN E FËMIJËS NË MOMENTIN E INTERVISTËS:	

PAMJA/ VEZHGIMI I FËMIJËS NË MOMENTIN E INTERVISTËS	**Jo shqetësues**	**Pak shqetësues**	**Shumë shqetësues**	**Komente**
A është i ushqyer fëmija?				
A është i veshur siç duhet fëmija?				
A është fëmija i pastër?				

A ka fjetur fëmija?				
A është zhvillimi i fëmijës në përputhje me normat e zhvillimit për moshën që ka?				
A është bashkëveprimi i fëmijës me ju i përshtatshëm për moshën e tij/saj?				
A është gjuha e përdorur nga fëmija e përshtatshme me moshën e tij/saj?				
A duket fëmija i trembur/ frikësuar apo i qetë (në dukje ose gjatë bisedës?				
A ka fëmija ndonjë shenjë abuzimi, si mavijosje apo plagë të pashpjegueshme?				
A shfaq ndonjë sjellje shqetësuese apo që nuk duket "Normale"?				
A duket fëmija se ka një marrëdhënie afeksionale me prindin apo duket i trembur (nëse është i shoqëruar)				
Të tjera vëzhgime (shtesë)				
PAMJA/VËZHGIMI I PRINDËRVE/SHOQËRUESVE *(nëse në atë moment fëmija është i shoqëruar)*				
A u treguan agresivë/ në pozicion mbrojtës prindërit gjatë vizitës?				
A shprehet prindi pozitivisht për fëmijën? A flet prindi në mënyrë negative për fëmijën/ shprehte me kritika të forta?				
A ekziston ndonjë gjë "e çuditshme" apo shqetësuese te sjellja e prindërve që mund të tregojë probleme të fshehura				
A flet prindi në mënyrë negative për fëmijën/ shprehet me kritika të forta?				
A përmendin prindërit ndonjë ide rreth përkujdesjes ndaj fëmijës që mund të shkaktojë shqetësim? P.sh ndëshkim fizik				
Shpjegim/shënim : (*Pasi është mbledhur info i parë, dy punonjësit diskutojnë për hapat e mëtejshëm në varësi të situatës së gjykuar. Më pas, ia komunikojnë/ informojnë/ shpjegojnë/ sqarojnë fëmijës dhe prindit/kujdestarit se çfarë mund të bëhet për të ndihmuar në atë moment fëmijën dhe prindin/kujdestarin).*				
Përcaktim për nivelin e rrezikut dhe arsyet (shpreh shqetësimet për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës):				
Hapat / veprimet për t'u ndërmarrë për t'iu përgjigjur situatës së fëmijës: *(p.sh., ofrim ushqim/veshmbathje/strehim; kthim në familje; largim në një qendër ditore etj.)*				
Plotësuar nga: _____ _____ _____ _____ **Data:** _____				

Pyetje te mundshme konkrete për mbledhjen e informacionit: *(mund te shtohen dhe te tjera)*

Nga vjen _____

Nëse vjen nga X qytet, vazhdohet me pyetjen me kë ka ardhur ____

A ke ngrënë/pirë dhe çfarë_____

A ke fjetur mbrëmë, ku dhe me kë ____

A ka ndonjë shqetësim me shëndetin ____

Sa kohë ke që je në rrugë ?____

A ka motra dhe vëllezër të tjerë?___

Info për familjen (nëna, babai, motra, vëllezër) _____

(ku janë ; a janë bashkë ; a ka kontakte)

Pyetje të tjera ndihmuese shoqëruese për të kuptuar situatën në rrugë (në varësi të gjendjes së fëmijës për t'u përgjigjur)

Ku jetojnë dhe ku punojnë/lypin?

Si kanë udhëtuar nga vendi që jetojnë deri aty ku punojnë/ lypin dhe sa kohë ju është dashur?

Kur filluan të punojnë/lypin dhe kur ndaluan?

Me kë kanë punuar/lypur ?

Çfarë pune tjetër, apo kanë qenë në shkollë gjatë ditës?

Kur e filluan dhe përfunduan këtë punë/shkollën?

Kur kanë bërë pushim dhe kanë ngrënë gjatë ditës?

Çfarë hëngrën?

Ku kanë punuar/ lypur?

Ku kanë fjetur?

ANEKS 3
FORMULARI I REFERIMIT

FORMULARI I REFERIMIT PËR FËMIJËN E SHFRYTËZUAR EKONOMIKISHT, PËRFSHIRË FËMIJËT NË SITUATË RRUGE		
Emri / identiteti i fëmijës:	**Data e lindjes:**	**Gjinia**:
Emri dhe adresa e kujdestarit parësor:	**Vendndodhja e fëmijës / Aty ku po rri fëmija:**	
Shkolla	**Shërbime të tjera në kontakt me fëmijën (p.sh. shëndetësia etj.)**	
Të dhëna mbi fëmijë të tjerë në shtëpi:		
Historik i shkurtër i familjes (nëse dihet):		
Arsyet për referim / shqetësimi:		
Puna e bërë / shërbimet e ofruara gjatë 7 ditëve të fundit:		

Emri dhe detajet e kontaktit të personit që bën referimin:	**Emri dhe detajet e kontaktit të personit që merr referimin:**	**Data kur është bërë referimi**

UDHËZIM
Nr. 9, datë 11.3.2019

MBI MODALITETET E TRANSFERIMITPRANË ADMINISTRATËS DOGANORE TË TË DHËNAVE PËR SUBJEKTET E AKCIZËS TË CILËT REZULTOJNË ME DETYRIME TË PAPAGUARA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikave 7 dhe 9, të nenit 157, të vendimit nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të detyrueshme mbi transferimin nga administrata tatimore për ndjekje nga administrata doganore të të gjitha detyrimeve të papaguara të akcizës, të periudhës pas vitit 2010, që janë kontabilizuar në administratën tatimore para datës 1 tetor 2012, si dhe për borxhet pas datës 1 tetor 2012, për detyrimet e akcizës që i përkasin periudhës para datës 1 tetor 2012.

2. Të gjitha detyrimet e papaguara të akcizës, të periudhës pas vitit 2010, që janë kontabilizuar në administratën tatimore para datës 1 tetor 2012, si dhe për borxhet e lindura pas datës 1 Tetor 2012, për detyrimet e akcizës që i përkasin periudhës para datës 1 tetor 2012, kalojnë në ndjekje të administratës doganore. Administrata tatimore përcjell menjëherë të gjithë informacionin në lidhje me detyrimet e prapambetura të akcizës. Ky proces përfundon në datë 7.5.2019.

3. Drejtoritë rajonale tatimore shqyrtojnë paraprakisht respektimin e hapave proceduriale për secilën dosje të subjekteve debitorë të akcizës dhe afatet e parashkrimit të së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese në harmoni me kërkesat e legjislacionit tatimor dhe atij doganor në fuqi.

4. Për subjektet të cilët plotësojnë kushtet ligjore për mbledhjen me forcë të borxhit, sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, bëhet paraprakisht edhe evidentimi nëse këto subjekte aktualisht janë me status aktiviteti "aktiv" apo "pasiv". Drejtoritë rajonale tatimore duhet të përgatisin informacionin e detajuar të të dhënave që përmban dosja e detyrimeve të papaguara, bashkë me dokumentacionin mbështetës, si dhe hapat e ndjekura nga këta të fundit sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

5. Transferimi sipas rregullave të arkivit për detyrimet e papaguara të akcizës kryhet nëpërmjet kalimit të dosjeve respektivisht për secilin debitor (dokumentacioni mbështetës provues për çdo hap te ndjekur nga ana e administratës tatimore, korrespondencën me institucione të tjera lidhur me ndjekjen e borxhit etj.), shoqëruar me formularët e transferimit të detyrimeve të papaguara të akcizës, bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij udhëzimi).

Këto formularë përgatiten nga strukturat përgjegjëse për mbledhjen me forcë në drejtoritë rajonale tatimore. Në formularët e transferimit përfshihet informacioni mbi të dhënat e subjektit, si dhe të dhëna të detajuara ku specifikohet: shuma e papaguar (ndarë në zëra dhe totale), nr./dt. e vendimit, nr./dt. e njoftim vlerësimit, data e kontabilizimit, statusi i subjektit, si dhe informacioni në lidhje me proceset gjyqesore.

Në shumën e detyrimit të papaguar përfshihen edhe kamatëvonesat e llogaritura deri në datën e plotësimit të formularit të transferimit. Llogaritja e kamatëvonesave bëhet nga Strukturat përgjegjëse për Analizën dhe Kontabilitetin në drejtoritë rajonale tatimore.

6. Të dhënat e detajuara në formularin e transferimit, për çdo rast do të rakordohen me të dhënat e administruara nga drejtoritë e kontrollit, Drejtoria e Kontabilitetit dhe Drejtoria e Borxhit pranë drejtorive rajonale tatimore, të cilat administrojnë tatimpaguesit e akcizës si subjekt të detyrimit të papaguar.

7. Formularët e transferimit për subjektet e akcizës me detyrime të papaguara, do të dërgohen nga ana e drejtorive rajonale tatimore përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, do të dërgojë të gjithë dosjet dhe formularët e transferimit të subjekteve të akcizës me detyrime të papaguara, sipas përcaktimeve të pikave 4, 5 dhe 6 të këtij udhëzimi, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në përputhje edhe me legjislacionin mbi arkivën.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në varësi të adresës ku subjekti debitor ka selinë, urdhëron degët doganore përkatëse për marrjen në

evidencë dhe kontabilizimin e borxhit të akcizës, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave deri në mbledhjen dhe shuarjen e këtij borxhi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Formulari i Transferimit të të Dhënave të Tatimpaguesve lidhur me detyrimet e papaguara te akcizës sipas të Dhënave në DRT

Ky formular duhet të plotësohet dhe firmoset nga drejtoritë rajonale tatimore që kërkojnë të transferojnë të dhëna për subjektet e akcizës të cilët rezultojnë me detyrime të papaguara.

1. DREJTORIA RAJONALE NGA BËHET TRANSFERIMI

_____

2. INFORMACION MBITATIMPAGUESIT

1. Emri i subjektit _____
2. Adresa (rruga, numri, kodi postal, qyteti): _____
3. NIPT: _____
4. Aktiviteti: _____
5. Formaorganizative:_____
6. Administratori_____
7. Telefoni/adresa e postës elektronike (e-mail):_____
8. Statusi_____

3. INFORMACION PËR DETYRIMET E TATIMPAGUESIT

Emri i subjektit_____
Nr. NIPT _____

Nr.	Detyrim te Papaguara				Vendimi		Njoftim Vleresimi		Dt e kontabilizimit	Statusi I subjektit	Proces gjyqesor		
	Detyrim Akcize	Penalitet	Kamate Vonese	Shuma Totale	Nr.	Dt.	Nr.	DT.			SHK I	SHK II	SHK III

Përsa më sipër, për llogari të kontrolluesit konfirmoj të dhënat të cilat transferohen, deklaroj vërtetësine dhe garantoj se është përfshirë i gjithë dokumentacioni përkatës.

Emri:_____
Data:_____
Firma:_____

4. DOSJA E SUBJEKTIT

Proces verbal i inventarit të dosjes

Për sa më sipër, për llogari të kontrolluesit konfirmoj të dhënat të cilat transferohen, deklaroj vërtetësinë dhe garantoj se është përfshirë i gjithë dokumentacioni përkatës.

Emri:
Data:
Firma:

UDHËZIM
Nr. 10, datë 15.3.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008, "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të paragrafit 1 të nenit 10, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 40.1 të shtohet fjalia:

Një individ me të njëjtin numër të identifikimit personal, mund të regjistrohet vetëm një herë si person fizik tregtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe pajiset vetëm me një numër unik të identifikimit të tatimpaguesit, në vijim NUIS/NIPT. Atij i lind e drejta të regjistrohet dhe të pajiset me një NUIS/NIPT të ri, nga QKB-ja, vetëm mbas çregjistrimit të NUIS/NIPT - in ekzistuese. Për çdo vend tjetër të ushtrimit të aktivitit të ndryshëm nga adresa kryesore, personi fizik duhet të pajiset me një certifikatë me numër unik të identifikimit të tatimpaguesit të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes së re.

2. Në fund të pikës 43.1 të udhëzimit, shtohet pikat 43.1.1, 43.1.2 dhe 43.1.3 me përmbajtjen e më poshtme:

43.1.1 Për çdo vend tjetër të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga vendi kryesor i

ushtrimit të aktivitetit, personi fizik, pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes të veprimtarisë së re.

43.1.2 Individët me të njëjtin numër të identifikimit personal, të cilët janë të pajisur me disa numra unik të identifikimit të tatimpaguesit (NUIS/NIPT), duhet që brenda datës 31.8.2019, të sistemojnë situatën e tyre, duke aplikuar në QKB për mbylljen e NIPT-ve të tjera dhe mbajtjen e një NIPT-i kryesor. Nëse do të vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet në adresat që do të mbyllen duhet të aplikojnë në QKB për hapjen e tyre si adresa dytësore të NIPT-it aktiv kryesor.

43.1.3 Nëse pas përfundimit të këtij afati konstatohet që një indivi me të njëjtin numër të identifikimit personal nuk ka zbatuar pikën 43.1.2 të këtij udhëzimi, administrata tatimore do te aplikojë vlerësimin alternativ të tatimpaguesit sipas nenit 71 pika "f") të ligjit për procedurat tatimore.

3. Te pika 44.1.1, germa "c", pas fjalisë së parë shtohet fjalia:

Qendra Kombëtare e Biznesit pranon pezullimin e aktivitetit të subjektit/tatimpaguesit vetëm kur nga ana e tij janë paguar të gjitha detyrimet tatimore në momentin e aplikimit për pezullimin e aktivitetit.

4. Pas paragrafit të katërt të pikës 44.1.1, shtohet paragrafi:

Në momentin e aplikimit të subjektit/tatimpaguesit për pezullim aktiviteti, QKB-ja bën verifikimin e detyrimeve tatimore të subjektit /tatimpaguesit. Miratimi i pezullimit të aktivitetit nga ana e QKB-së për çdo subjekt/tatimpagues bëhet pasi është verifikuar më parë situata e detyrimeve tatimore të tij në momentin e aplikimit për pezullim dhe ka rezultuar një nga rastet si më poshtë:

a) Subjekti/tatimpaguesi nuk ka detyrime;

b) Subjekti/tatimpaguesi ka paguar detyrimet tatimore, fakt i cili vërtetohet nga mandati i bankës, të cilit duhet ti bashkëlidhet edhe urdhërpagesa. Shuma e detyrimeve në mandat pagesë, duhet të përputhet me shumën e detyrimit në urdhërpagesë. Urdhërpagesa duhet të jetë e printuar dhe të jetë paguar shuma totale e detyrimit, jo më parë se 3 ditë kalendarike nga data e aplikimit për pezullim.

Subjekti/tatimpaguesi që ka lidhur marrëveshjeje për pagesë me këste të detyrimit tatimor, nuk mund të pezullojë veprimtarinë ekonomike.

Verifikimi i detyrimeve tatimore nga ana e QKB-së do të bëhet sipas procedurës së përcaktuar në marrëveshjen dhe protokollin e komunikimit midis DPT-së dhe QKB-së.

5. Pika 44.7 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

44.7 Në faqen e zyrtare të administratës tatimore, www.tatime.gov.al, publikohet dhe përditësohet çdo ditë pune, lista e tatimpaguesve që kanë kaluar në regjistrin pasiv. Gjithashtu, tatimpaguesi duhet të konsultohet me regjistrin tregtar të publikuar në faqen zyrtare të QKB-së, www.qkb.gov.al. Çdo tatimpagues përpara se të hyjë në një transaksion me një tatimpagues tjetër, duhet të verifikojë statusin e tij dhe të sigurohet që blerësi apo shitësi është tatimpagues me status "Aktiv" dhe mund të kryejë transaksione.

Do të konsiderohet shkelje administrative, çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, të cilët në datën e kryerjes së transaksionit, rezultojnë të jenë me statusin pasiv, dhe dënohen si më poshtë vijon:

a) Për shitësin, i cili është në regjistrin pasiv, bëhet vlerësim tatimor pasi të jetë aktivizuar më parë (kaluar në status aktiv) kryesisht nga DRT-ja e juridiksionit përkatës dhe vendoset dënim, në përputhje me nenin 116 të ligjit. Ky aktivizim bëhet nga data e kryerjes të transaksionit.

b) Për blerësin, vlerësim tatimor për mosnjohjen e TVSH-së së zbritshme dhe të shpenzimit.

Me përjashtim të transaksioneve të kryera nga subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e telekomunikacionit, shitjes së energjisë dhe ujit për konsumatorët finalë, sigurimeve, si dhe në rastet kur janë lidhur kontrata afatgjata leasing, do të konsiderohet shkelje administrative, çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit aktiv, persona fizikë apo juridikë tregtarë, me tatimpaguesit që janë në regjistrin pasiv, dhe dënohet, si më poshtë vijon:

a) shitësi aktiv, në përputhje me pikën 2, të nenit 128, të ligjit. Ky dënim nuk aplikohet vetëm për ditët gjatë cilave lista e tatimpaguesve në regjistrin pasiv nuk është përditësuar nga administrata tatimore për arsye teknike dhe;

b) blerësi në regjistrin pasiv, me vlerësim tatimor të detyrimit, pasi është aktivizuar më parë (kaluar në status aktiv) kryesisht nga DRT-ja e juridiksionit përkatës dhe vendoset dënim, në

përputhje me nenin 116 të ligjit. Ky aktivizim bëhet në datën e konstatimit të transaksionit.

6. Pika 45 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

45. Çregjistrimit i tatimpaguesve/subjekteve

45.1 Subjektet/tatimpaguesit, personat fizikë dhe juridikë, që regjistrohen sipas dispozitave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar dhe organizatat jofitimprurëse ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja, organizatat politike, organizatat që kryejnë veprimtari fetare, humanitare, bamirëse, publike, shkencore, arsimore etj., të cilat nuk kanë për qëllim fitimin të cilat regjistrohen në përputhje me legjislacionin e fushës, çregjistrohen nga regjistri i administratës tatimore vetëm pas çregjistrimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose në gjykatë.

Subjektet/tatimpaguesit e regjistruar në organin tatimor si me poshtë, çregjistrohen nga drejtoritë rajonale tatimore, të juridiksionit përkatës:

a) persona juridikë, të cilët nuk regjistrohen në Regjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si përfaqësi e ambasada të huaja, entet publike kombëtare apo vendore, njësitë e zbatimit të projekteve të veçanta dhe persona të tjerë të ngjashëm me to;

b) përfaqësuesit tatimorë të tatimpaguesve jorezidentë;

c) të vetëpunësuarit në veprimtari, si shitës ambulant të cilët janë persona fizikë që tregtojnë mallra ose shërbime për publikun pa pasur një vend biznesi fiks, që ushtrojnë aktivitetin në njësi të vetme tregtimi të lëvizshme dhe lejohet të tregtojë në ambiente publike pasi janë pajisur me leje nga bashkia nën juridiksionin territorial dhe administrativ;

d) kryefamiljari, që punëson individë, si punëtorë shtëpie, kujdestarë dhe persona të tjerë të kësaj natyre;

e) fermeri.

Data e çregjistrimit të tatimpaguesit në administratën tatimore është data e çregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në gjykatë, për të gjitha subjektet që çregjistrohen pranë tyre.

Data e çregjistrimit të personave juridikë publikë apo të ngjashme me to, si dhe të institucioneve e organizatave ndërkombëtare, është data e aktit/vendimit të mbylljes nga institucioni përkatës.

Datë e çregjistrimit për subjektet / tatimpaguesit e tjerë është data e miratimit të çregjistrimit të tyre nga administrata tatimore.

45.2 Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve, që janë pjesë e regjistrit të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Të gjithë tatimpaguesit persona fizik apo juridik, të regjistruar sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, në QKB, çregjistrohen nga regjistri i administratës tatimore mbas çregjistrimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

45.3 Çregjistrimi i tatimpaguesve persona fizikë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

a) Tatimpaguesi person fizik, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, që kërkon të çregjistrohet, për çfarëdo arsye, është i detyruar të paguajë më parë të gjitha detyrimet tatimore të papaguara dhe të dorëzojë deklaratat përkatëse, deri në datën e kërkesës/aplikimit për çregjistrim. Kërkesa për çregjistrim paraqitet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas procedurave ligjore përkatëse. Qendra Kombëtare e Biznesit, me pranimin e kërkesës/aplikimit për çregjistrim duhet të njoftojë menjëherë organin tatimor në rrugë elektronike, mbi datën e kërkesës/aplikimit për çregjistrimin e tij. Me marrjen e njoftimit mbi datën e aplikimit për çregjistrim, administrata tatimore ndërpret gjenerimin e deklaratave tatimore dhe tatimpaguesi nuk ka asnjë detyrim të mëtejshëm për deklarim.

b) Drejtoria Rajonale e Tatimeve e juridiksionit përkatës, brenda 10 ditëve pune nga data e aplikimit për çregjistrim, kryen të gjitha verifikimet dhe vlerësimet e duhura dhe pasqyron situatën tatimore në llogarinë elektronike të tatimpaguesit. Verifikimi përfshin të gjitha detyrimet tatimore, detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat aktuale të lidhura me këto detyrime, si dhe deklaratat tatimore të padorëzuara. Për tatimpaguesit persona fizikë të regjistruar për përgjegjësinë tatimore Tatim Fitimi, kur administrata tatimore, sipas analizës së riskut, gjykon të nevojshme të ushtrojë kontroll tatimor në mjediset e veprimtarisë së subjektit, ky kontroll dhe pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit nuk mund të zgjasë më shumë se 30 ditë pune. Ky afat fillon nga data e aplikimit për çregjistrim.

c) Qendra Kombëtare e Biznesit, verifikon elektronikisht shumën e detyrimeve tatimore të papaguara apo deklaratave të padorëzuara të

subjektit/tatimpaguesit, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe në protokollin elektronik të komunikimit me DPT-në.

Për subjektet/tatimpaguesit që nuk janë të regjistruar për përgjegjësinë tatimore Tatim Fitimi, verifikimi bëhet pas mbarimit të afatit 10 ditë pune.

Për subjektet/tatimpaguesit e regjistruar për përgjegjësinë tatimore Tatim Fitimi, verifikimi bëhet pas mbarimit të afatit 30 ditë punë, bazuar në pikën 3 të nenit 45 të ligjit.

Në raste të veçanta, kur deklaratat/pasqyrat financiare janë dorëzuar nga subjektet manualisht pranë DRT-së përkatëse por në sistem rezultojnë si të padorëzuara ose kur tatimpaguesi ka paguar të gjitha detyrimet tatimore, por pagesa nuk është shfaqur në llogarinë e tij, si dhe në raste të tjera të kësaj natyre, komunikimi ndërmjet DRT-ve dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, mund të bëhet me shkresë zyrtare ose me postë elektronike (e-mail).

d) Nëse pas afateve të sipërpërmendura, QKB-ja konstaton se tatimpaguesi nuk ka detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit, duke njoftuar në rrugë elektronike administratën tatimore për datën e çregjistrimit të tij.

e) Kur pas afateve të sipërpërmendura, QKB-ja konstaton se tatimpaguesi ka detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara, apo nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit, (kur tatimpaguesi është subjekt i tatim fitimit), nuk mund të kryejë çregjistrimin e tij.

45.4 Çregjistrimi i tatimpaguesve persona juridikë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

a) Tatimpaguesit persona juridikë, që kryejnë veprimtari ekonomike fitimprurëse çregjistrohen sipas dispozitave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, dhe pas kryerjes prej tyre të procedurave të likuidimit të njohura nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Aplikimi për fillimin e procedurës të likuidimit paraqitet në Qendrën Kombëtare të Biznesit. QKB-ja njofton menjëherë organin tatimor për miratimin e aplikimit për fillimin e procedurës së likuidimit dhe në vijim kur shoqëria dorëzon raportin përfundimtar të likuidimit dërgon në organin tatimor datën e paraqitjes së këtij raporti. Administrata tatimore e pasqyron këtë njoftim (dorëzimin e raportit përfundimtar) si kërkesë për çregjistrim të personit juridik në dosjen elektronike të tij dhe në vijim nuk i gjenerohen deklarata tatimore nga sistemi për periudhën pasardhëse.

b) Administrata tatimore, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së raportit përfundimtar të likuidimit është e detyruar të kryejë të gjitha verifikimet dhe vlerësimet e duhura dhe pasqyron situatën tatimore në llogarinë elektronike të tatimpaguesit. Verifikimi përfshin të gjitha detyrimet tatimore, detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat aktuale të lidhura me këto detyrime, si dhe deklaratat tatimore të padorëzuara. Kur administrata tatimore, sipas analizës së riskut, gjykon të nevojshme të ushtrojë kontroll tatimor në mjediset e veprimtarisë së subjektit, ky kontroll dhe pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit nuk mund të zgjasë më shumë se 30 ditë pune. Ky afat fillon nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar të likuidimit.

c) Qendra Kombëtare e Biznesit, verifikon elektronikisht shumën e detyrimeve tatimore të papaguara apo deklaratave të padorëzuara të subjektit/tatimpaguesit, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe në protokollin elektronik të komunikimit me DPT-në. QKB-ja nuk mund të verifikojë situatën tatimore të tatimpaguesit para mbarimit të afatit 30 ditë punë.

Në raste të veçanta, kur deklaratat/pasqyrat financiare janë dorëzuar nga subjektet manualisht pranë DRT-së përkatëse por në sistem rezultojnë si të padorëzuara ose kur tatimpaguesi ka paguar të gjitha detyrimet tatimore, por pagesa nuk është shfaqur në llogarinë e tij, si dhe në raste të tjera të kësaj natyre, komunikimi ndërmjet DRT-ve dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, mund të bëhet me shkresë zyrtare ose me postë elektronike (e-mail).

d) Nëse pas afatit të sipërpërmendur, QKB-ja konstaton se tatimpaguesi nuk ka detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara, si dhe ka paraqitur pasqyrat financiare, kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit, duke njoftuar në rrugë elektronike administratën tatimore për datën e çregjistrimit të tij.

e) Kur pas afatit të sipërpërmendur, QKB-ja konstaton se tatimpaguesi ka detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara, apo nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit, nuk mund të kryejë çregjistrimin e tij.

45.5 Qendra Kombëtare e Biznesit ka detyrimin ligjor të njoftojë administratën tatimore, menjëherë me paraqitjen e aplikimit për riorganizimin e shoqërive (bashkim/ndarje) të përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, i cili ka si pasojë çregjistrimin pa likuidim të shoqërive që përthithen/ndahen.

Administratori/Eksperti i caktuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ose personi i autorizuar sipas ligjit, është i detyruar të njoftojë dhe dorëzojë në administratën tatimore raportin e bashkimit, si dhe dokumentacionin përkatës. Para se të regjistrojë bashkimin/ndarjen e shoqërive, duhet të ketë paguar detyrimet tatimore të shoqërive që do të çregjistrohen pa likuidim.

Administrata tatimore brenda 30 ditëve pune nga data e marrjes dijeni për aplikimin për bashkim/ndarje, është e detyruar të kryejë të gjitha verifikimet dhe vlerësimet e duhura për situatën tatimore të tatimpaguesve të cilët bashkohen/ndahen. Verifikimi përfshin të gjitha detyrimet tatimore, detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, gjobat dhe kamatëvonesat aktuale të lidhura me këto detyrime, si dhe deklaratat tatimore të padorëzuara.

Kur administrata tatimore, sipas analizës së riskut, gjykon të nevojshme të ushtrojë kontroll tatimor në mjediset e veprimtarisë së subjektit që do të përthithet/ndahet ky kontroll dhe pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit nuk mund të zgjasë më shumë se 30 ditë pune. Ky afat fillon nga data e marrjes së njoftimit për paraqitjen e aplikimit për riorganizimin e shoqërive (bashkim/ndarje).

Nëse çregjistrimi pa likuidim është kryer pa u shlyer më parë detyrimet tatimore të subjektit që riorganizohet (bashkohet/ndahet), këto detyrime do të vazhdojnë të qëndrojnë në llogarinë e tij/tyre deri në pagimin e detyrimeve nga shoqëria përthithëse apo shoqëritë pritëse në rastin e ndarjes. Këto detyrime tatimore do të jenë të kërkueshme në mënyrë solidare kundrejt çdo subjekti që mbetet aktiv pas riorganizimit të shoqërive. Kjo nënkupton të drejtën e administratës tatimore, që detyrimet tatimore t'ia kërkojë çdo subjekti, që mbetet aktiv pas riorganizimit të shoqërive pavarësisht marrëveshjes që mund të kenë këto subjekte gjatë procesit të riorganizimit.

Afatet dhe procedura e shkëmbimit zyrtar të informacioneve midis QKB-së, gjykatës dhe administratës tatimore për çregjistrimin e shoqërive pa likuidim, janë ato të përcaktuara si më sipër.

Përveç respektimit të afateve dhe procedurës së shkëmbimit të informacionit midis këtyre institucioneve, Drejtoria Rajonale Tatimore përkatëse ndjek dhe procedon si vijon:

Drejtoria Rajonale Tatimore, duhet të depozitojë në dosjen elektronike të secilit tatimpagues, i cili përfshihet në këtë proces ndryshimet dhe dokumentacionin përkatës ligjor për sa u përket vendimeve të organeve vendimmarrëse të personave juridikë, si dhe dokumentacionin ekonomik që lidhet me pasqyrat financiare përkatëse apo aktet e ekspertëve kontabël nëse ka të tilla, sikurse parashikohet në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe çdo dokumentacion që shoqëron bashkimin/ndarjen.

Drejtoria Rajonale Tatimore harton një pasqyrë përmbledhëse të detyrimeve tatimore debitore dhe kreditore të shoqërive të përfshira në këtë proces, të cilën e depoziton në dosjen e tatimpaguesit. Nëse pas përfundimit të verifikimeve përkatëse nga Drejtoria Rajonale Tatimore, shoqëria që do të përthithet/ndahet është kreditore në organin tatimor për ndonjë lloj tatimi, atëherë teprica kreditore:

a) Do të përdoret për kompensim të detyrimeve tatimore të tjera të tatimpaguesit, nëse ka të tilla;

b) Do t'i kthehet/rimbursohet tatimpaguesit nëse plotësohen kushtet sipas procedurave të përcaktuara në nenin 75 dhe 75/1 të ligjit "Për procedurat tatimore në RSH", të ndryshuar ose nenin 77 të ligjit "Për TVSH-në", i ndryshuar;

c) Do ta kalojë nëpërmjet transferimit të shoqëria përthithëse (në rastin e bashkimit) apo shoqëria/shoqëritë e reja që krijohen (në rastin e ndarjes).

Në rastin kur tatimpaguesit e përfshirë në proces bashkimi/ndarjeje të shoqërive, administrohen nga dy drejtori të ndryshme rajonale tatimore, drejtoria rajonale, e cila çregjistron pa likuidim tatimpaguesin, njofton dhe shkëmben informacion për tepricat kreditore përkatëse të tatimpaguesit që do të çregjistrohet, pasi kanë ndjekur radhën e veprimeve të përcaktuara më sipër.

Për kalimin e tepricës kreditore të çdo lloj tatimi në rastet sa më sipër, organi tatimor realizon transferimin e tepricës nëpërmjet procedurës informatike të transferimit të kredisë nga një person i tatueshëm në një tjetër person të tatueshëm, sipas formularit përkatës.

Për realizimin e transferimit të kredisë, inspektori përkatës i drejtorinë rajonale, i bashkëngjit formularit të transferimit të kredisë një procesverbal ose akt rakordimi, si dhe të gjithë dokumentacionin shoqërues për të vërtetuar arsyet e këtij transferimi të kredisë.

Teprica kreditore që i rezulton tatimpaguesit për një tatim të caktuar në organin tatimor mbartet në periudhat në vijim dhe shoqëron situatën e personit derisa të ekzistojë kjo tepricë. Detyrimi tatimor që një shoqëri ka ndaj organit tatimor, i cili përket një periudhe të caktuar tatimore, një vlerësimi të caktuar tatimor, nuk mund të mbartet në vijueshmëri në periudhat pasuese, dhe tatimpaguesi është përgjegjës për të deri sa ta shlyejë.

Bazuar në dispozitat e nenit 224 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si shoqëria përthithëse, administratorët e saj etj., në rastin e bashkimit të shoqërive, ashtu edhe shoqëritë pritëse, administratorët e tyre etj., në rastin e ndarjes së shoqërive, përgjigjen për detyrimet e shoqërive debitore.

Nëse këto detyrime nuk paguhen, procedurat e mbledhjes do të ndiqen ndaj shoqërive përthithëse/pritëse ose shoqërive të reja të krijuara, si përgjegjëse për këto detyrime në bazë të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në të kundërt, ashtu sikurse parashikon ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, brenda 6 muajve nga publikimi i projekt-marrëveshjes së bashkimit, organi tatimor në rolin e kreditorit paraqet me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimit të tyre dhe shoqëria duhet t'i japë garanci të mjaftueshme për kreditë e tij. Nëse detyrimet nuk paguhen ose nuk jepet garanci e mjaftueshme nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, organi tatimor mund t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë lëshimin e garancive të mjaftueshme apo anulimin e vendimit të bashkimit. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që bashkohen, përgjigjen në mënyrë solidare për të gjitha dëmet e shkaktuara ndaj organit tatimor, si pasojë e pasaktësisë së deklaratës së mësipërme.

Në rastin kur ndonjëra nga shoqëritë që do të çregjistrohet pa likuidim si pasojë e procesit të bashkimit/ndarjes së shoqërive është debitore, administrata tatimore mbledh detyrimin tatimor sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar.

QKB-ja njofton organin tatimor për dorëzimin e raportit përfundimtar të bashkimit/ndarjes dhe dërgon elektronikisht datën e paraqitjes së këtij raporti. Administrata tatimore e pasqyron këtë njoftim (dorëzimin e raportit përfundimtar) si kërkesë për çregjistrim të personit juridik në dosjen elektronike të tij dhe në vijim nuk i gjenerohen deklarata tatimore nga sistemi për periudhën pasardhëse.

QKB-ja duhet të dërgojë në organin tatimor vendimin përfundimtar të bashkimit/ndarjes dhe datën e miratimit të aplikimit për depozitimin e këtij vendimi. Administrata tatimore pas plotësimit të kushteve ligjore kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit. Data e çregjistrimit të tatimpaguesit është data e çregjistrimit të tij pa likuidim në QKB.

45.6 Çregjistrimi/likuidimi i tatimpaguesve / subjekteve në gjykatë

45.6.1 Organizatat jofitimprurëse ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja, organizatat politike, organizatat që kryejnë veprimtari fetare, humanitare, bamirëse, publike, shkencore, arsimore etj. dhe organet e tjera të ngjashme me to, çregjistrohen sipas legjislacionit përkatës. Subjektet/ tatimpaguesit e sipërpërmendur që kërkojnë të çregjistrohen për çfarëdo arsye, paraprakisht janë të vdetyruar që të paguajë të gjithë detyrimet tatimore të papaguara.

Çregjistrimi fillon në gjykatë nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për hapjen e procedurës së likuidimit. Gjykata, me marrjen e kërkesës për çregjistrim prej subjektit/tatimpaguesit, njofton menjëherë me shkrim organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit. Ky njoftim administrohet si informacion nga DRT-të në dosjen e tatimpaguesit. Me paraqitjen e raportit përfundimtar nga OJF-të në gjykatë, kjo e fundit njofton me shkrim DRT-së përkatëse, e cila e pasqyron këtë njoftim si kërkesë për çregjistrim të OJF-së në dosjen elektronike të saj dhe në vijim nuk i gjenerohen deklarata tatimore nga sistemi për periudhën pasardhëse.

Administrata tatimore, brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes se njoftimit për paraqitjen në gjykatë të raportit përfundimtar të likuidimit, është e detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve dhe njofton gjykatën dhe subjektin mbi këtë situatë. Verifikimi përfshin të gjitha llojet e detyrimeve tatimore të subjektit, përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe gjobat e kamatëvonesat eventuale të lidhura me këto detyrime, si dhe deklaratat e padorëzuara. Kur organi tatimor, sipas analizës së riskut, gjykon se është e nevojshme të ushtrojë kontroll në mjedisin ku ushtron veprimtarinë subjekti/tatimpaguesi, atëherë ky afat nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë kalendarike, përfshirë kryerjen e kontrollit.

Nëse nga këto verifikime apo nga kontrolli rezulton se, subjekti ka detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara, apo nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve duhet të paraqesë në gjykatë kundërshtimin e saj me shkrim për çregjistrimin e tij brenda afatit 30 ditor (kalendarike). Në kundërshtimin e çregjistrimit, tregohet shuma e detyrimeve tatimore të papaguara dhe fakti që nuk ka dorëzuar deklarata tatimore apo nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e likuidimit përfundimtar. Pas kundërshtimit me shkrim të organit tatimor të dërguar brenda 30 ditëve kalendarike, gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin.

Nëse organi tatimor nuk i përgjigjet gjykatës brenda afatit 30-ditor (kalendarike), gjykata çregjistron subjektin/tatimpaguesin dhe njofton në të njëjtën ditë organin tatimor dhe tatimpaguesin. Në këtë rast, përgjegjësia është e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, drejtori i së cilës nxjerr përgjegjësinë personale të punonjësve dhe propozon masat përkatëse disiplinore ndaj tyre.

Kur subjekti paguan detyrimet e papaguara dhe dorëzon deklaratat e padorëzuara, si dhe pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit, administrata tatimore njofton menjëherë gjykatën për situatën e tij tatimore. Vërtetimi i lëshuar nga organi tatimor që konfirmon shlyerjen e detyrimeve nga subjekti, mund të paraqitet në gjykatë edhe nga vetë ai. Në këto raste gjykata kryen çregjistrimin dhe dërgon në administratën tatimore dokumentin e çregjistrimit të subjektit, përfshirë datën e çregjistrimit.

45.6.2 Në rastet e likuidimit të thjeshtëzuar, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nr. 9901, datë 14.4.2008, i ndryshuar, gjykata njofton menjëherë organin tatimor kompetent (DRT ku është regjistruar tatimpaguesi) për fillimin e kësaj procedure dhe datën e zhvillimit të seancës për shqyrtimin e kësaj kërkese. Administrata tatimore e pasqyron këtë njoftim si kërkesë për çregjistrim të personit juridik në dosjen elektronike të tij dhe në vijim nuk i gjenerohen deklarata tatimore nga sistemi për periudhën pasardhëse. Administrata tatimore, brenda datës së caktuar për zhvillimin e seancës gjyqësore është e detyruar të njoftojë gjykatën për situatën tatimore të tatimpaguesit. Gjykata me marrjen e vendimit për çregjistrimin e subjektit/tatimpaguesit, njofton në të njëjtën ditë DRT -në dhe tatimpaguesin.

45.6.3 Në rastet e fillimit të procedurës së falimentimit, gjykata njofton menjëherë organin tatimor kompetent (DRT-ja ku është regjistruar tatimpaguesi) për fillimin e kësaj procedure.

Gjykata me marrjen e vendimit për fillimin, pezullimin dhe përfundimin e procedurës së falimentimi së tatimpaguesit/subjektit, njofton në të njëjtën ditë DRT-në përkatëse dhe tatimpaguesin.

45.7 Çregjistrimi i tatimpaguesve që regjistrohen vetëm në administratën tatimore.

Të gjithë personat e tjerë (entet publike qendrore ose lokale, personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi ambulant, kryefamiljarët që punësojnë individë si punëtorë shtëpie, përfaqësuesit tatimorë etj.) të regjistruar në administratën tatimore, por që nuk kanë detyrimin për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në gjykatë, kur kërkojnë të çregjistrohen, për çfarëdo arsye qoftë, janë të detyruar të paguajnë më parë të gjithë detyrimet e tyre tatimore. Kërkesa për çregjistrim paraqitet në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku tatimpaguesi është regjistruar.

Me paraqitjen e kërkesës për çregjistrim të këtyre tatimpaguesve, administrata tatimore e pasqyron këtë aplikim si "Kërkesë për çregjistrim" në dosjen ekektronike të tij dhe në vijim nga kjo datë, atij nuk i gjenerohen deklarata tatimore nga sistemi për periudhën pasardhëse.

Në rastin e çregjistrimit të përfaqësuesve tatimorë, Drejtoria Rajonale e Tatimeve të juridiksionit përkatës, brenda 10 ditëve pune nga marrja e kërkesës për çregjistrim të tatimpaguesit, kryen të gjithë verifikimet e duhura lidhur me

situatën tatimore të tij. Verifikimi përfshin të gjitha detyrimet tatimore, si dhe gjobat dhe kamatëvonesat të lidhura me këto detyrime. Drejtoria Rajonale e Tatimeve, përveç verifikimit të situatës tatimore të tatimpaguesit, kur e gjykon të nevojshme, mund të ushtrojë edhe një kontroll tatimor, në bazë të analizës së riskut, në mjediset ku tatimpaguesi ushtron veprimtarinë e tij. Ky kontroll nuk mund të jetë më shumë sesa 30 ditë pune.

Tatimpaguesit e tjerë të regjistruar në administratën tatimore, të cilët nuk kanë detyrime tatimore të papaguara dhe deklarata tatimore të padorëzuara, çregjistrohen brenda 30 ditëve nga data e aplikimit të tyre për çregjistrim. Në këtë rast administrata tatimore pajis subjektin/tatimpaguesin me dokumentin e çregjistrimit.

Tatimpaguesit, të cilët nuk i kanë paguar detyrimet tatimore apo kanë deklarata tatimore të padorëzuara, çregjistrohen vetëm pas përmbushjes së këtyre detyrimeve. Pas çregjistrimit administrata tatimore pajis subjektin/tatimpaguesin me dokumentin e çregjistrimit.

Çregjistrimi i fermerit bëhet sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar.

45.8 Efektet e çregjistrimit

Subjektet që regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përpara çregjistrimit përfundimtar dorëzojnë certifikatën e regjistrimit në QKB. Subjektet që regjistrohen në gjykatë si dhe ato që regjistrohen vetëm në administratën tatimore, pas çregjistrimit dorëzojnë certifikatën e regjistrimit, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve të juridiksionit.

Çregjistrimi i subjektit/tatimpaguesit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, gjykatë apo administratë tatimore, nuk eliminon detyrimet tatimore të papaguara dhe nuk e ndalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë me forcë detyrimet tatimore.

7. Pika 67.2 riformulohet si vijon:

Tatimpaguesi ka të drejtë për të korrigjuar deklaratat e tij tatimore vetëm brenda 36 muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare mujore, tre-mujore apo vjetore, sa herë konstaton gabime dhe pasaktësi në deklarim. Tatimpaguesi e humbet të drejtën për të korrigjuar deklaratat e tij në ulje detyrimi, sipas parashikimit të kësaj pike, nëse deklarata, që ai kërkon të korrigjojë, është kontrolluar nga administrata tatimore.

8. Pika 68.5 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

68.5 Shuma e detyrimit tatimor e detyrueshme për t'u paguar ose shuma e tepricës së kredisë, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, me vlerë deri në 1000 (një mijë) lekë, e cila ka ardhur si rezultat i një vlerësimi të kryer nga administrata tatimore, vlerësohet si detyrim ose kredi me vlere zero.

9. Te pika 71.1 të udhëzimit shtohet pika "f" me përmbajtjen si vijon:

"f) kur tatimpaguesi me status "person fizik" konstatohet nga administrata tatimore se regjistron ose mban më shumë se një numër identifikimi unik të subjektit dhe dorëzon deklarata të veçanta për çdo NIPT/NUIS, për qëllime të shmangies tatimore dhe minimizimit të detyrimit tatimor.

Në këtë rast, administrata tatimore nëpërmjet vlerësimit alternativ në vend ose nga zyra, bën vlerësimet e duhura për deklarimin e të ardhurave, ndryshimin e përgjegjësive tatimore, të NUIS/NIPT që do të përcaktojë tatimpaguesi. NUIS/NIPT-et e tjera tatimpaguesi, mund ti regjistrojë si adresa sekondare (dytësore) të NUIS/NIPT kryesor.

10. Në pikën 71.1, kudo ku përmendet, të hiqet fjalia:

Në asnjë rast, ky vlerësim nuk mund të bëhet direkt nga zyra.

11. Në pikën 71, pas paragrafit 71.3.1 shtohet paragrafi 71.4 me këtë përmbajtje:

71.4 Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor

71.4.1 Në rastet kur tatimpaguesi/tatimpaguesit kryejnë veprime apo transaksione apo seri veprimesh apo transaksionesh, në mënyrë direkte apo indirekte me persona të tretë, të cilat deformojnë parimet e ligjit tatimor, nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut, janë pa efekte ekonomike thelbësore, forma nuk reflekton thelbin e tij ekonomik, apo evidentohen elemente të veprimeve/ transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore, administrata tatimore ka të drejtën e rikarakterizimit të këtyre transaksioneve me qëllim përcaktimin e detyrimit të saktë tatimor.

71.4.2 Për këtë qëllim, administrata tatimore nuk

merr parasysh një veprim/transaksion apo një seri veprimesh/ transaksionesh, të cilat, duke qenë se konkludohet që janë ndërmarrë me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e ligjit, rezultojnë fiktive në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave. Në këto kushte, veprimi/transaksioni rikarakterizohet dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ të parashikuar në ligjin e procedurave tatimore apo ligjet e tjera tatimore.

71.4.3 Barrën e provës për të vërtetuar se veprimet/transaksionet janë ndërmarrë nga tatimpaguesi apo tatimpaguesit, me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e ligjit, e ka administrata tatimore.

71.4.4 Nëse administrata tatimore konkludon se rasti është brenda konceptit të nenin 71/2 të ligjit dhe e argumenton këtë sipas pikës 71.4.3 më sipër, ajo i lejon tatimpaguesit që të paraqesë prova, dokumente dhe argumente që tregojnë se 'qëllimin biznesor' apo 'thelbin ekonomik i transaksionit /transaksioneve' të ndërmarra nuk ka qenë përfitimi i avantazheve tatimore.

71.4.5 Në rastin e një veprimi/transaksioni apo një seri veprimesh/transaksionesh të një tatimpaguesi, për të vlerësuar nëse jemi në situatat sipas paragrafëve 71.4.1 dhe 71.4.2 më sipër, administrata tatimore analizon dhe vlerëson efektin e detyrimeve tatimore të gjeneruara në zinxhirin e plotë të veprimeve/transaksioneve ndërmjet tatimpaguesve që analizohen. Nëse veprimet/transaksionet nuk kanë çuar në uljen e detyrimeve tatimore, apo nuk janë zgjedhur dhe përdorur elemente te tillë si statusi juridik i tatimpaguesit, niveli tarifor i taksimit për kategori të ndryshme tatimpaguesish, nuk aplikohen dispozitat e nenit 71/2 të ligjit.

71.4.6 Tatimpaguesit kanë të drejtë të zgjedhin formën juridike dhe atë të regjistrimit që parashikon legjislacioni përkatës i fushës. E drejta e tatimpaguesit për të zgjedhur formën e organizimit, e cila është në përputhje me ligjet në fuqi, nuk mund të interpretohet si shmangie e detyrimeve tatimore, dhe nuk përbën shkak për zbatimin e nenit 71/2 të ligjit. Procedurat e nenit 71/2 zbatohen në ato raste kur administrata tatimore konkludon se veprime që kanë të bëjnë me statusin e tatimpaguesit, apo formën e regjistrimit të tij, janë ndërmarrë duke shfrytëzuar në mënyrë jo të ndershme ndryshime ligjore që favorizojnë tatimpagues me statuse të ndryshme.

Shembull 1: Punonjësi A.M. ka qenë i punësuar me kontratë pune si inxhinier IT-je pranë subjektit "Sky". Në momentin kur ndryshon regjimi i taksimit të biznesit të vogël, p.sh., kur tatimi për intervalin e qarkullimit 0–5 milionë bëhet zero, individi A.M. ndërpret marrëdhëniet e punësimit dhe regjistrohet në QKB si person fizik tregtar, duke ofruar vetëm në kompaninë "Sky" të njëjtat shërbime që ofronte edhe më parë si i punësuar me kontratë, por duke shmangur detyrimet tatimore që paguante si çdo i punësuar. Në raste të tilla administrata tatimore analizon me kujdes veprimet dhe transaksionet në mënyrë që të dallojë veprime/transaksione që bëhen më qëllim shmangien apo uljen e detyrimeve tatimore, nga ngjarje apo situata kur një individ kalon normalisht nga statusi "i punësuar" në statusin e "profesionistit të lirë" dhe ofron shërbime jo vetëm te tatimpaguesi ku ishte i punësuar.

Shembull 2: Tatimpaguesi "TradeAlb9" person juridik, ushtron veprimtarinë e tregtimit të produkteve ushqimore dhe paguan 15 % tatim mbi fitimin. Ky subjekt zhvillon veprimtarinë në 10 adresa sekondare të tregtimit me shumicë dhe pakicë të mallrave që tregton. Për të përfituar avantazhe tatimore, subjekti "TradeAlb9" mbyll disa apo të gjitha adresat sekondare. Në këto adresa regjistrohen biznese të tjera, të cilat furnizohen nga subjekti "TradeAlb9", por që paguajnë tatim mbi fitimin me tarifë 0 % (për qarkullim 0–5 milionë) ose 5 % (për qarkullim 5–15 milionë). Në këtë rast, administrata tatimore analizon hollësisht faktet dhe rrethanat, dhe pasi krijon bindjen se veprimet/ transaksionet janë ndërmjet personave të lidhur, direkt apo indirekt, dhe janë ndërmarrë me qëllim përfitimin e avantazheve tatimore, të cilat vijnë në kundërshtim me qëllimin dhe frymën e ligjit, rikarakterizon transaksionet duke llogaritur shumën e duhur të detyrimit tatimor që do të paguhej në kushte normale të zhvillimit të biznesit.

71.4.7 Administrata tatimore duhet të analizojë situatën dhe të dallojë rastet kur tatimpaguesi / tatimpaguesit kryejnë veprime apo transaksione apo seri veprimesh apo transaksionesh, në mënyrë direkte apo indirekte me persona të tretë, veprime të cilat deformojnë parimet e ligjit tatimor, nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut, apo janë pa

efekte ekonomike thelbësore, nga rastet kur tatimpaguesit ka të drejtë ligjore për të zgjedhur formën e organizimit dhe regjistrimit të cilat lidhen me një trajtimin të caktuar fiskal. E drejta e tatimpaguesit për të zgjedhur formën e regjistrimit që është në përputhje me ligjin, nuk duhet të interpretohet në çdo rast si shkelje e parimeve të nenit 71/2 të ligjit, duke mos përbëre shkak për rivlerësim nga administratat tatimore.

Shembull 1. Individi "D.N" i cili më parë ka qenë i punësuar në kompaninë "L2", pajiset me licencën "Kontabël i Miratuar" dhe synon të hyjë në tregun e shërbimeve dhe konsulencës në këtë fushë. Ai regjistrohet në QKB si person fizik tregtar dhe deklaron qarkullimin 4.5 milionë lekë në vit që pret të realizojë, duke përcaktuar në këtë mënyrë edhe pozicionin e tij tatimor. Pasi regjistrimit, ai lidh kontrata shërbimi e konsulence me subjekte të ndryshme, dhe deklaron të ardhurat që realizon. Në këtë rast, administrata tatimore nuk mundet që pa prova dhe fakte të qenësishme, të kërkojë zbatimin e nenit 71/2 dhe të llogarisë për individin "D.N." detyrime që i përkasin regjimeve të tjera tatimore.

71.4.8 Për zbatimin e nenit 71/2 të ligjit, administrata tatimore ka të drejtën e rikarakterizimit të transaksioneve me qëllim përcaktimin e detyrimit të saktë tatimor vetëm nëse:

i) Drejtoria Rajonale e Tatimeve ka paraqitur kërkesë të argumentuar dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka miratuar përdorimin e nenit 71/2 të ligjit, me qëllim rikarakterizimin e transaksioneve për tatimpaguesin / tatimpaguesit.

ii) Rikarakterizimi i transaksioneve bëhet në kuadrin e një kontrolli tatimor në vend, duke ekzaminuar dhe analizuar dokumentacionin.

71.4.9 Rikarakterizimi i transaksionit dhe përdorimi i metodave alternative të vlerësimit për përcaktimin e detyrimit tatimor, në rastet kur aplikohet neni 71/2 i ligjit, në thelb është vlerësim alternativ nga administrata tatimore. Qëllimi i këtij vlerësimi alternativ është që të përcaktojë se sa duhej të ishte detyrimi tatimor ligjor i pagueshëm nga tatimpaguesi, nëse nuk do të ishim në kushtet e moskryerjes së veprimeve apo transaksione të cilat deformojnë parimet e ligjit tatimor, nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut, apo evidentohen elemente që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore. Nëse nuk ka prova dhe fakte që jemi para një rasti të evazionit tatimor, por vërehen elementë të shmangies tatimore "ligjore", administrata tatimore nuk mund të aplikojë penalitetet e nenit 116 të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

12. Në pikën 75/1.1, te pika 1 "Rregullat e rimbursimit", paragrafi i tetë që përcakton subjektet që rimbursohen brenda 30 ditëve, por duke iu nënshtruar analizës së riskut ndryshon si vijon:

Nëse tatimpaguesi nuk është eksportues me risk zero (eksportues vlera e eksporteve të kryera prej të cilit është më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve përfshirë eksportet), por i nënshtrohet regjimit të përpunimit aktiv ose është eksportues, vlera e eksporteve të të cilit përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve përfshirë eksportet, duhet të rimbursohet brenda 30 ditëve, por duke iu nënshtruar më parë analizës së riskut.

13. Pas pikës 75.2 të udhëzimit shtohet pika 75.3 me përmbajtje si më poshtë:

Kompensimi nga teprica kreditore i detyrimeve tatimore brenda çdo tatimi, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kryhet automatikisht nga sistemi informatik.

14. Në krye të pikës 79, shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë:

Pagesat e kryera për çdo tatim, përveç pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, fillimisht do të shkojnë për të mbyllur detyrimet më të hershme brenda të njëjtit lloj detyrimi, në qoftë se këto detyrime nuk janë në proces apelimi, gjykimi apo në marrëveshje të pagesës me këste të detyrimeve tatimore të papaguara.

15. Pika 89.1, ndryshon si më poshtë:

89.1 Duke pasur parasysh përmbushjen e dispozitave të pikës 88 më lart, kur administrata tatimore, arrin në përfundimin se një detyrim tatimor nuk është paguar plotësisht, ajo menjëherë njofton tatimpaguesin për detyrimin e papaguar, nëpërmjet postës rekomande ose në rrugë elektronike.

Njoftimi nga ana e administratës tatimore mund të bëhet edhe me forma të tjera të dërgimit të njoftimit, përveç postës dhe rrugës elektronike, duke përfshire edhe dorëzimin dorazi të njoftimit kundrejt konfirmimit të marrjes së tij prej tatimpaguesit.

Njoftimi përmban shumën e detyrimit të papaguar, llojin e tatimit apo të sanksionit që pason në rast të mos pagimit, fillimin e aplikimit të masave shtrënguese.

Njoftimi i kërkesës për pagimin e detyrimit tatimor, nxirret nga personi përgjegjës, apo çdo person tjetër i cili e ka të drejtën e nxjerrjes se njoftimit, si e drejtë e deleguar, apo si një e drejte e rrjedhur për shkak të funksioneve që ai kryen.

Në rastin kur detyrimet tatimore që do të paguhen janë të pushtetit vendor, njoftimi nxirret nga Kryetari i Zyrës Tatimore te qeverisjes vendore. Njoftimi i tatimpaguesit për të paguar detyrimet tatimore, nxirret brenda 10 ditëve nga ana e administratës tatimore, dhe ky afat fillon të llogaritet nga data kur tatimpaguesi ka pasur detyrimin për ta paguar atë.

Administrata tatimore duhet ta nxjerrë njoftimin e kërkesës për pagim brenda tri ditëve pune nga dita e parë e punës pas përfundimit të afatit ligjor për pagimin e detyrimeve. Njoftimi vendoset në dosjen e tatimpaguesit brenda 5 ditëve nga data e dërgimit te tij me poste rekomande, në rrugë elektronike apo nga data kur njoftimi i është dorëzuar dorazi tatimpaguesit kundrejt konfirmimit të këtij të fundit për marrjen e tij. Me kalimin e 10 ditëve nga data e nisjes me postë të këtij njoftimi ose brenda 3 ditëve nga data e dorëzimit dorazi tatimpaguesit të njoftimit apo në rrugë elektronike, fillon zbatimi i procedurës për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore.

16. Në pikën 90.1 shtohet fjalët si më poshtë:

Ky urdhër bllokimi i dërgohet bankave te të cilat administrata tatimore ka dijeni se tatimpaguesi, ose administratori apo pronarët e shoqërisë tregtare, kanë llogarite e tyre, si dhe të gjitha bankave të tjera me seli në Republikën e Shqipërisë, me postë rekomande ose në rrugë elektronike.

17. Pika 103.7 ndryshon si më poshtë:

103.7. Detyrimi tatimor ose një pjesë e tij i deklaruar i pambledhshëm, në zbatim të nenit 103 të ligjit, pasqyrohet si i tillë në regjistrin kontabël të detyrimeve.

18. Pas pikës 103.7 shtohen pikat 103.8 dhe 103.9, me këtë përmbajtje:

103.8 Fillimi i procedurës për deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshëm mund të bëhet me kërkesë nga ana e tatimpaguesit ose kryesisht nga ana e administratës tatimore në juridiksionin e të cilës është regjistruar tatimpaguesi.

103.9 Në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe mënyra të tjera të gjykuara si të domosdoshme nga ana e administratës tatimore, në fillim të çdo viti do të bëhet publikimi i vlerës totale të tatimeve të deklaruara sipas nenit 103 të ligjit si të pambledheshme. Publikimi duhet të përfshije edhe numrin në total të kërkesave të paraqitura nga tatimpaguesit për të kërkuar deklarimin si të pambledhëshme të detyrimeve të tyre tatimore, dhe sa kërkesa janë pranuar nga ato që i janë paraqitur administratës tatimore.

19. Në pikën 106.1.2, në fjalinë e parë hiqet shprehja "(jo vetëm ato me shkrim)" dhe pas germës "dh" shtohet germa "e" me përmbajtje "njoftimet për regjistrimin e tatimpaguesit në një përgjegjësi tatimore".

20. Në pikën 106.1.3, shtohen germat "ç" dhe "d" me përmbajtje si më poshtë:

"ç) Aktet administrative të bllokimit të veprimtarisë së tatimpaguesit, sipas neneve 41 dhe 122 të ligjit

d) Një detyrim tatimor apo një veprim/mosveprim i administratës tatimore, për të cilin Drejtoria e Apelimit Tatimor apo Komisioni për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore ka vendosur më parë, nuk mund të bëhet sërish objekt ankimi administrativ, pavarësisht nëse pasqyrohet në një akt të ri administrativ".

21. Pika 106.2.2 ndryshohet në përmbajtje si më poshtë:

"Në qoftë se ankimi dorëzohet pranë një organi jokompetent (për shembull në zyrën tatimore rajonale ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve), afati i ankimit vlerësohet i respektuar nëse kërkesa është paraqitur në kohë pranë organit jokompetent"

22. Në pikën 106.2.4, germa "ç" shtohen fjalët "ose garancinë bankare" dhe shtohet germa "f" me përmbajtje si më poshtë:

"dokumentacionin që vërteton datën e marrjes së njoftim vlerësimit të ankimuar (kopje të zarfit postar nëpërmjet të cilit është dërguar akti administrativ i ankimuar apo konfirmim nga shërbimi postar, ose konfirmim nga drejtoria rajonale tatimore, kur ky akt është marrë dorazi pranë saj)".

23. Në fjalinë e dytë të pikës 106.3.1, fjala "shtatë" zëvendësohet me "dhjetë".

24. Në fund të pikës 106.3.1 shtohen paragrafët me përmbajtje si më poshtë:

"Nëse edhe pas procedurave të përcaktuara në pikën 106.2.5 të udhëzimit, tatimpaguesi nuk provon datën e marrjes së aktit të ankimuar, afati i ankimit fillon nga e nesërmja e nxjerrjes së aktit ose pranimit të tij nga shërbimi postar.

Nëse tatimpaguesi nuk e ka marrë njoftim vlerësimin për shkak të një gabimi në njoftim nga administrata tatimore, afati 30 ditor i ankimit fillon në ditën kur marrësi provon nëpërmjet dokumentacionit përkatës se ka marrë dijeni për njoftimin".

25. Në fund të pikës 106.3.3 shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë:

"Ankimi duhet të paraqitet jo më parë se 7 ditë dhe jo më vonë se 45 ditë nga data e përfundimit të afatit tremujor, i cili konsiderohet si afat për përfundimin e procedurës administrative"

26. Në fund të pikës 106.3.4 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Kërkesa për rivendosje në afat të ankimit duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga marrja e njoftim vlerësimit, duke paraqitur njëkohësisht ankimin dhe duke paguar apo vendosur garancinë bankare për detyrimin e përcaktuar në njoftim vlerësimin e ankimuar. Kërkesa për rivendosje në afat duhet të përmbajë shkaqet e arsyeshme dhe dokumentacionin vërtetues për mosparaqitjen e ankimit brenda afatit të ankimit. Shkaqe të arsyeshme konsiderohen rrethanat e parashikuara në pikën 111.4.2 të udhëzimit. Nëse adresa në të cilën administrata tatimore ka dërguar aktin e ankimuar përputhet me adresën e deklaruar nga tatimpaguesi dhe nuk vërtetohet një nga shkaqet e arsyeshme të mësipërme, mosmarrja e njoftimit brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 23 të ligjit, është në përgjegjësinë e vetë tatimpaguesit".

27. Pika 106.4.1, ndryshohet në përmbajtje si më poshtë:

"Tatimpaguesi dorëzon ankimin pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose komisionit, e cila duhet ta regjistrojë kërkesën ankimore me të dhënat përkatëse në sistemin tatimor".

28. Pika 106.4.2 shfuqizohet.

29. Pika 107.1, germa "a" ndryshohet në përmbajtje si më poshtë:

"paguan shumën e plotë të detyrimit tatimor, objekt ankimi, të përcaktuar në aktin administrativ që ankimohet ose vendos garanci bankare për këtë shumë me afat minimalisht 6 muaj, me qëllim shqyrtimin administrativ, por jo me pak se afati në të cilin vendimi merr formë të prerë, gjatë shqyrtimit gjyqësor"

30. Në fund të germës "b" të pikës 107.1, shtohet fjalia me përmbajtjen

Një kopje e garancisë bankare dorëzohet nga tatimpaguesi pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore që ka nxjerrë aktin administrativ të ankimuar".

31. Pikat 107.2.1 dhe 107.2.2 ndryshohen në përmbajtje si më poshtë:

"107.2.1 Shuma e pagueshme ose shuma e vënë si garanci bankare, në përputhje me pikën 1 të nenit 107 të ligjit, përjashton gjobat dhe kamatëvonesat e llogaritura, të përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

107.2.2 Tatimpaguesi pajiset nga Drejtoria Rajonale tatimore me urdhër pagese ku pasqyrohen saktësisht tatimi i pagueshëm, pas kompensimeve automatike të kryera nga sistemi informatik. Kur tatimpaguesi është në procedure apelimi nuk lejohet përfundimi i një marrëveshje për pagesën me këste të detyrimit që apelohet.

Nëse detyrimi në njoftimin e vlerësimit nuk përputhet me vlerësimin e regjistruar në sistemin informatik, tatimpaguesi duhet të paguajë apo vendosë garanci bankare për detyrimin tatimor sipas njoftim vlerësimit".

32. Në fjalinë e dytë të pikës 107.3.1, hiqen fjalët "dhe kamatëvonesat përkatëse".

33. Në fund të paragrafit 108.2.1 shtohet fjalia me përmbajtje "Në të tilla raste, afati i shqyrtimit të ankimit zgjatet 30 ditë".

34. Në pikën 108.3.3, paragrafi i parë riformulohet si më poshtë:

"Vendimi i Drejtorisë së Apelimit Tatimor duhet të nënshkruhet dhe vuloset nga drejtori i Drejtorisë së Apelimit Tatimor ose nëpunësi zëvendësues në përputhje me ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Vendimi i Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e funksionimit të Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore". Nënshkrimi nga të gjithë anëtarët bëhet në ekzemplarin e vendimit që mbahet në sekretari-arkiv, ndërsa vendimet që i dërgohen palëve pjesëmarrëse në procedurë nënshkruhen vetëm nga kryetari i KSHAT-it".

35. Në fund të pikës 109.5 shtohen fjalitë me përmbajtje

"por jo shumë se 6 muaj nga momenti i nisjes së pezullimit. Nëse me mbarimin e këtij afati çështja e mëparshme nuk është zgjidhur, pezullimi ndërpritet dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor vijon me shqyrtimin e ankimit. Në rastet e pezullimit të procedurës, nëse pas nëntë muajsh nga momenti i dorëzimit të kërkesës fillestare, Drejtoria e Apelimit Tatimor apo Komisioni nuk kanë nxjerrë vendimin, ankimuesi mund të ankimojë drejtpërsëdrejti në gjykatë".

36. Në pikën 110.3, pas fjalëve "shqyrtimin administrativ të aktit," shtohet fjala "nuk".

37. Pas pikës 115.1.2, shtohen pikat 115.1.3 me këtë përmbajtje:

115.1.3 Deklarim i pasaktë konsiderohet edhe rasti kur, si rezultat i një kontrolli tatimor, bëhet rivlerësim në ulje i tepricës kreditore të tatimpaguesit. Në këtë rast tatimpaguesi penalizohet me gjobë 20% të diferencës ndërmjet tepricës kreditore të deklaruar me tepricën kreditore që duhej deklaruar.

38. Pas pikës 115.1.3, shtohen pikat 115.1.4 me këtë përmbajtje:

Dënimet për mosnjoftimin e ndryshimeve në lidhje me ndryshimin e pronësisë. Nëse një person juridik nuk njofton administratën tatimore lidhur me ndryshimet e pronësisë, sipas kërkesave të nenit 27/1, "Ndryshimi i pronësisë", të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, ai është përgjegjës dhe dënohet, si më poshtë vijon:

a) Për shkeljen në rastin e pikës 3, të nenit të sipërpërmendur, 15 (pesëmbëdhjetë) për qind të vlerës së tregut të aktiveve të trajtuara si me ndryshim pronësie;

b) Për shkeljen në rastin e pikës 4, të nenit të sipërpërmendur, 5 (pesë) për qind të vlerës së tregut të aksioneve ose interesave të ngjashme që u ka ndryshuar pronësia.

Dënimi, sipas shkronjës "b" më sipër, nuk zbatohet kur vërtetohet që personi nuk ishte në dijeni të ndryshimit të pronësisë apo nuk ka të dhëna, prova apo fakte që të besohet se personi duhet të ishte në dijeni.

39. Pas pikës 124.1 shtohen fjalia me këtë përmbajtje:

Nëse tatimpaguesi pranon vlerësimin tatimor dhe e paguan detyrimin, atëherë gjoba sipas paragrafit më lartë të kësaj pike, zbritet me 30 (tridhjetë) për qind. Administrata tatimore do të kryejë zbritjen e gjobës pas paraqitjes së kërkesë me shkrim nga tatimpaguesi pranë DRT-së përkatëse, kërkesë të cilës i bashkëlidhet edhe mandati i pagesës.

40. Në fund të pikës 129, shtohen fjalia me këtë përmbajtje:

Në çdo rast, shuma e gjobës që zbatohet nuk mund të jetë më e madhe se shuma e kërkuar për t'u bllokuar.

41. Pika 133.4, e udhëzimit hiqet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

UDHËZIM
Nr. 11 , datë 15.3.2 2019

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008, PËR TAKSAT KOMBËTARE, I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2.8.8. 1 bëhen këto ndryshime:

- Kudo përpara paragrafit me titull "Shembuj:", hiqet togfjalëshi "*nga subjektet prodhuese*".

- Në paragrafin me titull "Shembuj:", në shkronjën "a", hiqet togfjalëshi "*të cilat importohen direkt nga prodhuesit vendas i materialeve të ndërtimit, apo të prodhimit të çdo lloj artikulli tjetër që nuk përfshihet në kapitullin 39 të NKM, si p.sh.: llaç, fino, grafiato, kollë etj. dhe...*", si dhe në shkronjat "b" dhe "c", hiqet togfjalëshi "*direkt nga prodhuesit vendas*" .

2. Në pikën 2.8.8.2 bëhen këto ndryshime:

- Në fjalinë e parë, pas fjalës "... prodhues...", shtohen fjalët "... *apo tregtues*..." .

- Në shkronjën "b", pas fjalës "... prodhon...", shtohen fjalët "... *apo tregton*..." .

- Shkronjat "c" dhe "d", hiqen.

- Në shkronjën "g" , në fjalinë e dytë, hiqet togfjalëshi "*nga vetë prodhuesi*".

3. Në pikën 2.8.8.3, shkronja "b", pika "ii", hiqet togfjalëshi "*nga vetë prodhuesi*".

4. Formulari i deklarimit dhe pagesës së taksave kombëtare, zëvendësohet me "*Formulari i deklarimit dhe pagesës së taksave kombëtare"* që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë e tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

FORMULAR I DEKLARIMIT TË TAKSAVE KOMBËTARE

Numri i Vendosjes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT):	(3)
Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm:	(4)
Emri Mbiemri i Personit Fizik:	(5)
Adresa:	(6)
Qyteti/Komuna/Rrethi:	
Numri Telefonit:	(7)

Lajmëroni nëse informacioni i mësiperm është jo i plotë ose ka ndryshuar

(8) Shënoni "x" nëqoftëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion ☐

1. TAKSA E QARKULLIMIT

Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend.

	Sasia e prodhuar	Shuma e taksës
1.1 Benzinë e prodhuar në vend [9;10]; 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59 (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014, 27102015, 27102016, 27102017, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00	[9] 0	[10] 0
1.2 Gazoil i prodhuar në vend [11;12]; 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48; (litra) 27102011, 27102012, 27102013,27102014; 27102015, 27102016, 27102017, 27102018, 27102019, 38 26 00	[11] 0	[12] 0

Deklarim për organet doganore

	Sasia e importuar	Shuma e taksës
1.3 Benzinë e importuar [13;14]; 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59 (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014, 27102015, 27102016, 27102017, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00	[13]	[14]
1.4 Gazoil i importuar [15;16]; 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48; (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014; 27102015, 27102016, 27102017, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00	[15]	[16]

2. TAKSA E KARBONIT

Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend

	Sasia e prodhuar	Shuma e taksës
2.1 Benzinë e prodhuar në vend [17;18]; 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59 (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014, 27102015, 27102016, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00	[17] 0	[18] 0
2.2 Gazoil i prodhuar në vend [19;20]; 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48; (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014; 27102015, 27102016, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00	[19] 0	[20] 0
2.3 Qymyr i prodhuar në vend [21;22;]; 2701; 2702 (kg)	[21] 0	[22] 0
2.4 Vajgur i prodhuar në vend [23;24;]; 27 10 19 11 - 27 10 19 29(litra)	[23] 0	[24] 0
2.5 Solar i prodhuar në vend [25;26]; 2710 19 62 deri në 2710 19 68 (kg)	[25] 0	[26] 0
2.6 Mazut i prodhuar në vend [27;28]; 2710 19 62 deri në 2710 19 68(kg)	[27]	[28]

2.7 Koks Nafte i prodhuar në vend [29; 30;]; 2713 11 00; 271312 00; (kg)	[29] 0	[30] 0

Deklarim për organet doganore

	Sasia e importuar	Shuma e taksës
2.8 Benzinë e importuar [31;32]; 2710 12 41; 2710 12 45; 2710 12 49; 2710 12 51; 2710 12 59 (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014, 27102015, 27102016, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00	[31]	[32]
2.9 Gazoil i importuar [33;34]; 2710 19 31; 2710 19 35; 2710 19 43; 2710 19 46; 2710 19 47; 2710 19 48; (litra) 27102011, 27102012, 27102013, 27102014; 27102015, 27102016, 27102018, 27102019, 27102090, 38 26 00	[33]	[34]
2.10 Qymyr i importuar [35; 36;]; 2701; 2702 (kg)	[35]	[36]
2.11 Vajgur i importuar [37; 38;]; 27 10 19 11 - 27 10 19 29 (litra)	[37]	[38]
2.12 Solar i importuar [39;40]; 2710 19 62 deri në 2710 19 68 (kg)	[39] 0	[40] 0
2.13 Mazut i importuar [41;42]; 2710 19 62 deri në 2710 19 68(kg)	[41]	[42]
2.14 Koks nafte i importuar [43; 44;]; 2713 11 00; 271312 00 (kg)	[43] 0	[44] 0

3. TAKSA E MATERIALEVE/ARTIKUJVE PLASTIKE DHE E AMBALAZHEVE PREJ PLASTIKE/QELQI

Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend të ambalazheve plastike

	Sasia prodh/ shitur	Shuma e taksës
[45;46;]; Amballazhe boshe (kg)	[45] 0	[46] 0
[47; 48;]; Mallra të amballazhuara në amballazh plastik (amballazh; kg)	[47] 0	[48] 0
	Sasia e ricik /shit.	Shuma e taksës
[49; 50;]; Amballazhe plastike nga riciklimi (kg)	[49] 0	[50] 0

Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend të amballazheve të qelqit

	Sasia e prodh/shitur	Shuma e taksës
[51; 52;]; Amballazhe boshe (kg)	[51] 0	[52] 0
[53; 54;]; Mallra të amballazhuara në amballazh qelqi (amballazh; kg)	[53] 0	[54] 0

Deklarim për organet doganore

	Sasia e importuar	Shuma e taksës
[55;56] Materiale/artikuj plastike dhe e ambalazheve plastike të importuara në Kapitullin 39 të NKM	[55]	[56]
[57;58] Lëndë të parë në forma primare të importuar "në krerët "3901", deri "3914" të NKM"	[57]	[58]
[59; 60;] Ambalazh qelqi të importuar	[59]	[60]

4. TAKSA MBI PËRDORIMIN E TRUALLIT SHTETËROR

Deklarim i personave pagues të taksës

	Vlera	Shuma e taksës
[61; 62;]; Vlera e sipërfaqes së truallit shtetëror në përdorim	[61]	[62]

5. TAKSA E MJETEVE TË PËRDORURA TË TRANSPORTIT RRUGOR

Deklarim për agjentin DPSHTRR

	Numri i mjeteve	Shuma e Taksës
[63;64]; Mjete të përdorura të transportit rrugor	[63] 0	[64] 0

6. TAKSA PORTUALE

Deklarim për Agjentin Kapiteneria e Porteve

- Prekje të portit

	Nr. prekje	Shuma e taksës
[65;66]; Anije shqiptare	[65] 0	[66] 0
[67;68]; Anije të huaja	[67] 0	[68] 0

7. TAKSA E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË PESHKIMIT

Deklarime për Agjentin Drejtoria e Politikave te Peshkimit

	Nr. Lejeve	Shuma e taksës
[69;70]; Peshkimi detar	[69] 0	[70] 0
[71;72]; Peshkimi artizanal me mjete të lehta	[71] 0	[72] 0
[73;74]; Peshkimi sportiv në det me mjete lundruese	[73] 0	[74] 0
[75;76]; Akuakultura	[75] 0	[76] 0

8. TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS

Deklarim për Agjentin Zyrat e Gjendjes Civile

	Nr. akteve / dokum	Shuma e taksës
[77;78] Për çertifikatë të lëshuar, për regjistrimin e shtetasve të huaj pas dhënies së shtetësisë shqiptare, për procedurën e ndryshimit të emrit/ mbiemrit, mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës, për procedurën për veçim/bashkim familjesh të shtetasve	[77] 0	[78] 0

9. TAKSA E PRIMIT TË SHKRUAR

Deklarim për Agjentin Shoqëritë e Sigurimit

	Primi i Shkruar	Shuma e taksës
[79;80]; Primet e shkruar me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil	[79] 0	[80] 0

10. TAKSA E REGJISTRIMIT FILLESTAR TË AUTOMJETEVE LUKSOZE

Deklarim për Agjentin D.P.SH.T.RR.

	Numri i Automjeteve	Shuma e taksës
[81:82]; Automjete luksoze të transportit rrugor	[81] 0	[82] 0

11. TAKSA E PËRVITSHME E AUTOMJETEVE LUKSOZE

Deklarim për Agjentin D.P.SH.T.RR.

	Numri i Automjeteve	Shuma e taksës
[83;84]; Automjete luksoze të transportit rrugor	[83] 0	[84] 0
85. TOTALI I TAKSAVE PËR T'U PAGUAR		[85]

dd.mm.yyyy, - Deklaroj nën përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

UDHËZUES PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT

1. Numri serial gjenerohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe shërben për të azhurnuar regjistrimet kur paraqitet deklarata.

2. Periudha tatimore është mujore ose pjesë e muajit në rast mbyllje të aktivitetit.

3. Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT) është numri i dhënë nga drejtoria rajonale tatimore ose Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe identifikon personin e tatueshëm në të gjitha marrëdhëniet me drejtorinë rajonale tatimore.

4. Emri tregtar i personit të tatueshëm është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në certifikatën e NIPT-it.

5. Emri, mbiemri i personit fizik vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një person fizik dhe nuk ka emër tregtar.

6. Adresa tregohet për vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë. Kjo adresë është treguar edhe në certifikatën e NIPT-it.

7. Numri i telefonit (n.q.s. ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.

8. Pa veprimtari zgjidhet vetëm nëse nuk është kryer aktivitet gjatë periudhës për të cilën bëhet deklarimi. Vendosni një kryq në kutinë 8, firmoseni deklaratën dhe paraqiteni në bankë.

1. TAKSA E QARKULLIMIT

 Deklarim për prodhuesit në vend

[9] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi të benzinës të prodhuar në vend (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[10] Taksa/litër shumëzuar me sasinë e benzinës të prodhuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi [9]

[11] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi të gazoilit të prodhuar në vend (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[12] Taksa/litër shumëzuar me sasinë e gazoilit të prodhuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi [11]

 Deklarim për importuesit

[13] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e benzinës të importuar (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[14] Taksa paguar në doganë për benzinën e importuar = Taksa/litër shumëzuar me sasinë e importuar të benzinë për muajin për të cilin bëhet deklarimi [13]

[15] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e gazoilit të importuar (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[16] Taksa paguar në doganë për gazoilin e importuar = Taksa/litër shumëzuar me sasinë e importuar të gazoilit për muajin për të cilin bëhet deklarimi [15]

2. TAKSA E KARBONIT

 Deklarim për prodhuesit në vend

[17] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi të benzinës të prodhuar në vend (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[18] Taksa/litër shumëzuar me sasinë e benzinës të prodhuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi [17]

[19] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi të gazoilit të prodhuar në vend (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[20] Taksa/litër shumëzuar me sasinë e gazoilit të prodhuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi [19]

[21] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e qymyrit të prodhuar në vend (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[22] Taksa/kg shumëzuar me sasinë e qymyrit të prodhuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi [21]

[23] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e vajgurit prodhuar në vend (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[24] Taksa/litër shumëzuar me sasinë e vajgurit të prodhuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi [23]

[25] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e solarit të prodhuar në vend (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[26] Taksa/kg shumëzuar me sasinë e solarit të prodhuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi [25]

[27] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e mazutit të prodhuar në vend (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[28] Taksa/kg shumëzuar me sasinë e solarit të prodhuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi [27]

[29] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e koksit të naftës të prodhuar në vend (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[30] Taksa/kg shumëzuar me sasinë e solarit të prodhuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi [29]

 Deklarim për importuesit

[31] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi të benzinës të importuar (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[32] Taksa e paguar në doganë për benzinën e importuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi = taksa/litër shumëzuar me sasinë e importuar të benzinës [31]

[33] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e gazoilit të importuar (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[34] Taksa e paguar në doganë për gazoilin e importuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi = taksa/litër shumëzuar me sasinë e importuar gazoilit [33]

[35] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e qymyrit të importuar (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[36] Taksa e paguar në doganë për qymyrin e importuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi = Taksa/kg shumëzuar me sasinë e qymyrit të importuar [35]

[37] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e vajgurit të importuar (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[38] Taksa e paguar në doganë për vajgurin e importuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi = Taksa/litër shumëzuar me sasinë e vajgurit të importuar [37]

[39] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e solarit të importuar (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[40] Taksa e paguar në doganë për solarin e importuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi = Taksa/kg shumëzuar me sasinë e solarit të importuar [39]

[41] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e mazutit importuar (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[42] Taksa e paguar në doganë për mazutin e importuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi = Taksa/kg shumëzuar me sasinë e mazutit të importuar [41]

[43] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e koksit të naftës të prodhuar në vend (sipas kodeve tarifore në deklaratë)

[43] Taksa e paguar në doganë për koksin e naftës të importuar për muajin për të cilin bëhet deklarimi = Taksa/kg shumëzuar me sasinë e solarit të importuar [43]

3. TAKSA E MATERIALEVE / ARTIKUJVE PLASTIKE DHE E AMBALAZHEVE PREJ PLASTIKE /QELQI

- Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend të materialeve/artikujve plastikë

[45] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e ambalazhit bosh plastik të prodhuar në vend dhe shitur.

[46] Taksa/kg shumëzuar me sasinë e ambalazhit plastik bosh të shitur [45]

[47] Sasia e ambalazhit plastik të mallrave të prodhuar në vend dhe të shitura

[48] Taksa/kg shumëzuar me sasinë e ambalazhit plastik të mallrave të prodhuara në vend dhe të shitur [47]

[49] Sasia e ambalazheve plastike nga riciklimi për muajin për të cilin bëhet deklarimi të prodhuar në vend dhe shitur

[50] Taksa/kg për ambalazhin e ricikluar shumëzuar me sasinë e ambalazhit plastik të prodhuar në vend nga riciklimi dhe të shitur [49]

- Deklarim për tatimpaguesit prodhues në vend të ambalazheve të qelqit

[51] Sasia për muajin për të cilin bëhet deklarimi e ambalazhit bosh qelqi të prodhuar në vend dhe shitur

[52] Taksa/kg shumëzuar me sasinë e ambalazhit të qelqit bosh të prodhuar në vend dhe të shitur [51]

[53] Sasia e ambalazhit të qelqit të mallrave të prodhuar në vend dhe të shitur

[54] Taksa/kg shumëzuar me sasinë e ambalazhit të qelqit të mallrave të prodhuara në vend dhe të shitur [53]

-Deklarim për organet doganore si agjente

[55] Sasi e ambalazheve plastike (a.bosh+ ambalazh i mallra të ambal.ambal.pastik) të importuar për muajin në të cilin deklarohet

[56] Taksa e paguar në doganë =Taksa/kg për ambalazhin plastik shumëzuar me sasinë e ambalazheve plastike (a.bosh+ ambalazh i mallra të ambal.ambal.pastik) të importuar [55]

[57] Sasi e Lëndë të parë në forma primare të importuar "në krerët "3901", deri "3914" të NKM" për muajin në të cilin deklarohet

[58] Taksa e paguar në doganë = Taksa/kg Lëndën e parë në forma primare të importuar "në krerët "3901", deri "3914" të NKM" [57]

[59] Sasi e ambalazheve të qelqit (a.bosh+ ambalazh i mallra të ambal.ambal.qelqi) të importuar për muajin në të cilin deklarohet

[60] Taksa e paguar në doganë = Taksa/kg për ambalazhin e qelqit shumëzuar me sasinë e ambalazheve të qelqit (a.bosh+ ambalazh i mallra të ambal.ambal.qelqi) të importuar [57]

4. TAKSA MBI PËRDORIMIN E TRUALLIT SHTETËROR

 Deklarim për personat pagues të taksës mbi përdorimin e truallit shtetëror

[61] Vlera në lekë e sipërfaqes të truallit shtetëror në përdorim

[62] Taksa e paguar = 10% shumëzuar me vlerën e sipërfaqes të truallit shtetëror në përdorim për muajin për të cilin deklarohet

5. TAKSA E MJETEVE TË PËRDORURA TË TRANSPORTIT

 Deklarim për agjentin DPSHTR

[63] Mjete të përdorura të transportit mbi të cilat është zbatuar taksa për muajin për të cilin deklarohet

[64] Taksa e paguar për këto mjete nga tatimpaguesit (deklarim i agjentit)

6. TAKSA PORTUALE

 Deklarim për agjentin Kapiteneria e Porteve dhe agjencitë detare shtetërore dhe private

[63] Nr. i prekjeve të portit nga anije shqiptare për muajin për të cilin deklarohet

[64] Taksa/prekje shumëzuar me nr. e prekjeve të portit nga anijet shqiptare, deklarim i agjentit

[65] Nr. i prekjeve të portit nga anije të huaja për muajin për të cilin deklarohet

[66] Taksa/prekje shumëzuar me nr. e prekjeve të portit nga anije të huaja, deklarim i agjentit

7. TAKSA E USHTRIMIT TË VEPRIM-TARISË SË PESHKIMIT

 Deklarim për agjentin Zyrat e Gjendjes Civile

[67] Nr. i lejeve të dhëna për peshkimin detar për muajin për të cilin deklarohet

[68] Taksa e paguar (Taksa/leje shumëzuar me nr. e lejeve [67], deklarim i agjentit)

[69] Nr. i lejeve të dhëna për peshkimin artizanal me mjete të lehta për muajin për të cilin deklarohet

[70] Taksa e paguar (Taksa/leje shumëzuar me nr. e lejeve [69] deklarim i agjentit)

[71] Nr. i lejeve të dhëna për peshkimin sportiv në det me mjete lundruese për muajin për të cilin deklarohet

[72] Taksa e paguar (Taksa/leje shumëzuar me nr. e lejeve [71] deklarim i agjentit)

[73 Nr. i lejeve të dhëna për akuakultura

[74] Taksa e paguar (Taksa/leje shumëzuar me nr. e lejeve [73] deklarim i agjentit)

8. TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS

 Deklarim për agjentin Zyrat e Gjendjes Civile

[75] Nr. certifikate të lëshuar, për regjistrimin e shtetasve të hua pas dhënies të shtetësisë shqiptare, për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës, për procedurën për veçim/bashkim familjesh të shtetasve për muajin për të cilin deklarohet

[76] Taksa /njësi shumëzuar me rubrikën [75], deklarim i agjentit

9. TAKSA E PRIMIT TË SHKRUAR

 Deklarim për Agjentin Shoqëritë e Sigurimit

[77] Primet e shkruara me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës; shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil

[78] Taksa/ njësi shumëzuar me rubrikën [77], deklarim agjentit

10. TAKSA E REGJISTRIMIT FILLESTAR TË AUTOMJETEVE LUKSOZE

 Deklarim për agjentin D.P.SH.T.RR.

[79] Automjete luksoze mbi të cilat është zbatuar taksa për muajin për të cilin deklarohet

[80] Taksa e paguar për këto mjete nga tatimpaguesit (deklarim i agjentit)

11. TAKSA E PËRVITSHME E AUTOMJETEVE LUKSOZE

 Deklarim për agjentin D.P.SH.T.RR.

[81] Mjete luksoze mbi të cilat është zbatuar taksa për muajin për të cilin deklarohet

[82] Taksa e paguar për këto mjete nga tatimpaguesit (deklarim i agjentit)

[83] Totali i paguar për muajin për të cilin deklarohet pranë drejtorisë rajonale tatimore nga çdo tatimpagues, plotësues i deklaratës. Totali i transferuar nga agjentet që plotësojë këtë deklaratë pranë drejtorisë rajonale tatimore.

UDHËZIM
Nr. 12, datë 15.3.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 30.1.2006 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 40, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 "Për Tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar bëhen ndryshimet e mëposhtme:

"Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin", bashkëlidhur udhëzimit, zëvendësohet me "Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

"Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat", bashkëlidhur udhëzimit, zëvendësohet me "Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zzyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESES SE TATIMIT MBI FITIMIN

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE

(2) Periudha tatimore	(1) Numri Serial:_____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshëm (NIPT):	**(3)** _____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshëm:	**(4)** _____
Emri Mbiemri i Personit Fizik:	**(5)** _____
Adresa:	**(6)** _____
Qyteti/Komuna/Rrethi :	
Numri Telefonit:	**(7)** _____

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plote ose ka ndryshuar

Llogaritja e rezultatit

Te ardhurat dhe shpenzimet	**Te ushtrimit**	**Tatimore**
(8/9) Te ardhurat	*(8)*	*(9)*
(10/11) Shpenzimet	*(10)*	*(11)*
(12) Shpenzimet e pazbritshme		*(12)*

Rezultati		
(13/14) Humbja	*(13)*	*(14)*
(15/16) Fitimi	*(15)*	*(16)*
(17) Humbje e mbartur		*(17)*
(18) Fitimi i tatueshëm neto (16-17)		*(18)*

Llogaritja e tatim fitimit

(19) Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 15 %	*(19)*
(20) Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 5%	*(20)*
(21) Tatim fitimi me përqindje të tjera	*(21)*
(22) Tatim fitimi (19+20+21)	*(22)*
(23) Tatim fitimi i shtyre	*(23)*
(24) Tatim Fitimi i detyrueshëm për t'u paguar	*(24)*

UDHËZUES PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT

A. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1. **Numri serial** gjenerohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe shërben për të azhornuar regjistrimet kur paraqitet deklarata
2. **Periudha Tatimore** është vjetore
3. **Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT)** është numri i dhënë nga QKR dhe që identifikon personin e tatueshëm në të gjitha marrëdhëniet me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve
4. **Emri Tregtar i Personit te Tatueshëm** është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në certifikatën e NIPT-it
5. **Emri, Mbiemri i Personit Fizik** vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një person fizik dhe nuk ka emër tregtar
6. **Adresa** tregohet vendi kryesor i ushtrimit të veprimtarisë. Kjo adresë është e treguar edhe në certifikatën e NIPT - it
7. **Numri i Telefonit** (nqs ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike

B. TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET

i. Llogaritja e rezultatit

8. **Të ardhurat e ushtrimit** janë të ardhurat totale të periudhës ushtrimore
9. **Të ardhurat tatimore** janë të ardhurat që i përkasin aktivitetit të tatueshëm
10. **Shpenzimet e ushtrimit** janë shpenzimet totale të periudhës ushtrimore
11. **Shpenzimet tatimore** janë shpenzimet që i përkasin aktivitetit të tatueshëm dhe që njihen si të zbritshme për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm
12. **Shpenzimet e pazbritshme** janë shpenzimet që i përkasin aktivitetit të tatueshëm dhe që nuk njihen si të zbritshme për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm

ii. Rezultati

13. **Humbja e ushtrimit** është diferenca e shpenzimeve të ushtrimit (kutia 10) me të ardhurat e ushtrimit (kutia 8) në rast se shpenzimet e ushtrimit janë më të mëdha se të ardhurat e ushtrimit
14. **Humbja tatimore** është diferenca e shpenzimeve tatimore (kutia 11) pasi të zbriten shpenzimet e pazbritshme (kutia12), me të ardhurat tatimore (kutia 9) në rast se shpenzimet tatimore pa shpenzimet e pazbritshme janë më të mëdha se të ardhurat tatimore
15. **Fitimi i ushtrimit** është diferenca e të ardhurave të ushtrimit (kutia 8) me shpenzimet e ushtrimit (kutia 10) në rast se të ardhurat e ushtrimit janë më të mëdha se shpenzimet e ushtrimit
16. **Fitimi tatimor** është diferenca e të ardhurave tatimore (kutia 9), me shpenzimet tatimore (kutia 11) pasi janë zbritur nga këto të fundit shpenzimet e pazbritshme në rast se të ardhurat tatimore janë më të mëdha se shpenzimet tatimore pa shpenzimet e pazbritshme.
17. **Humbje e mbartur** është humbja e mbartur nga periudhat paraardhëse dhe që njihet për efekte tatimore për t'u mbuluar nga fitimet e periudhës që deklarohet.
18. **Fitimi i Tatueshëm neto** është fitimi që mbetet nga fitimi tatimor (kutia 16) pasi zbritet humbja e mbartur (kutia 17)

iii. Llogaritja e tatim fitimit

Shënim : Nëse zbatoni dy ose më shumë shkallë tatimore dhe duhet të ndryshoni vlerën e kutive 19, 20, 21, vlerë e cila është e parallogaritur me shkallën tatimore standarte 15 %, atëherë duhet të klikoni kutinë në deklaratë " ■ shënoje këtë kuti për të ndryshuar vlerën e shumës"

19. **Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 15 %** është vlefta e tatim fitimit e llogaritur sipas vitit ushtrimor përkatës, në bazë të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar)
20. **Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 5%** është vlefta e tatim fitimit e llogaritur sipas vitit ushtrimor përkatës, në bazë të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar)
21. **Tatim fitimi me përqindje të tjera** është shuma e tatimeve të llogaritura me përqindje të tjera (nëse ka) ndaj fitimit të tatueshëm neto sipas ligjeve të tjera të veçanta
22. **Tatim fitimi** është shuma e tatimit të llogaritur me shkallën tatimore standarde 15 % (kutia 19), shuma e tatimit të llogaritur me shkallën tatimore standarde 5% (kutia 20) dhe me Tatim fitimin me përqindje të tjera (kutia 21)
23. **Tatim fitimi i shtyrë** është shuma e llogaritur e tatim fitimit, e cila për shkak të lehtësive tatimore (nëse ka) nuk duhet të paguhet në organet tatimore, por vetëm të rezervohet dhe të paguhet në rast të thyerjes së kushtit për të cilin është përfituar lehtësia tatimore)
24. **Tatim fitimi i detyrueshëm për t'u paguar** është shuma e tatim fitimit t'u detyrueshëm për tu paguar

FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT TË MBAJTUR NË BURIM MBI TË ARDHURAT

Numri i Vendosjes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):	(3)
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:	(4)
Emri Mbiemri i Personit Fizik:	(5)
Adresa:	(6)
Qyteti/Komuna/Rrethi:	
Numri Telefonit:	(7)

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plotë ose ka ndryshuar

I. LLOJET E PAGESAVE PËR TË CILAT MBAHET TATIM NË BURIM

		Tatimi në burim
[8] Dividendët	[8] 0	[8/1] 0
[9] Ndarjet e fitimit	[9] 0	[9/1] 0
[10] Interesat	[10] 0	[10/1] 0
[11] Pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale	[11] 0	[11/1] 0
[12] Pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, sherbimet e konsulences, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit	[12] 0	[12/1] 0
[13] Pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues	[13] 0	[13/1] 0
[14] Pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikqyrëse që lidhen me to	[14] 0	[14/1] 0
[15] Pagesat për qiratë	[15] 0	[15/1] 0
[16] Pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose spotistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë, apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre	[16] 0	[16/1] 0
[17] Të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë	[17] 0	[17/1] 0
[18] Pagesat për kalimin e të drejtës së pronësisë me shitje	[18] 0	[18/1] 0
[19] Pagesat për kalimin e të drejtës së pronësisë me dhurim	[19] 0	[19/1] 0

II. TATIMI I MBAJTUR NË BURIM

[20] Total tatimi i llogaritur, i mbajtur për t'u paguar {[8/1]+[9/1]+...+[19/1]}	[20] 0
[21] TOTALI PËR T'U PAGUAR	[21] 0

, - Deklaroj nën përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

UDHEZUES PER MENYREN E PLOTESIMIT TE FORMULARIT TE DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT TË MBAJTUR NË BURIM MBI TË ARDHURAT

1. **Numri serial [1] gjenerohet nga Drejtoria** Rajonale Tatimore dhe shërben për të azhornuar regjistrimet kur paraqitet deklarata.
2. **Periudha Tatimore [2] është mujore.**
3. **Rubrika 3 - 7 Gjeneralitete.** Shënoni të dhënat e subjektit siç paraqiten në formular dhe tregoni nëse të dhënat e paraqitura nuk janë **të plota ose kanë ndryshuar.**
4. **Rubrika [8] Dividendët** plotësohet me shumat e pagesave për dividendet që i kryhen aksionerit/ve pas miratimit te rezultatit financiar dhe miratimit të destinimit të fitimit.
5. **Rubrika [9] Ndarjet e fitimit** plotësohen me shumat e pagesave për ndarjet e fitimit që i kryhen ortakut pas miratimit të rezultatit financiar dhe miratimit te destinimit të fitimit.
6. **Rubrika [10] Interesat** plotësohet me shumën e interesave që paguhen gjatë muajit për të cilin deklarohet.
7. **Rubrika [11] Pagesat për të drejtat e autorit dhe pronësinë intelektuale** plotësohet me shumen e pagesave që lindin nga perdorimi apo e drejta per te perdorur te drejtat e autorit dhe pronesine intelektuale.
8. **Rubrika [12] Pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet e konsulencës, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit** plotësohet me pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet e konsulencës, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit.
9. **Rubrika [13] Pagesat për menaxhimin dhe pjesemarrjen në kishillat drejtues** plotësohet me shumën e pagesave që kryhen për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në keshillat drejtues**.**
10. **Rubrika [14] Pagesat për ndertimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to,** plotësohet me shumën e pagesave që kryhen për ndertimin, instalimin, montimin ose për punë mbikeqyrese që lidhen me to.
11. **Rubrika [15] Pagesat për qiratë** plotësohet me shumën e pagesave që kryhen për qiramarrjen e pasurive të luajtshme/paluajtshme.
12. **Rubrika [16] Pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshire pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artiste ose sportiste, apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre** plotësohet më shumën e pagesave që kryhen për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre.
13. **Rubrika [17] Të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë** janë pagesat e përfituara nga individët për fitimin në lojërat e fatit dhe kazinotë.
14. **Rubrika [18] Pagesat për kalimin e të drejtës së pronësisë me shitje** plotësohet me shumën e pagesave që kryhen për kalimin e pronësisë me shitje
15. **Rubrika [19] Pagesat për kalimin e të drejtës së pronësisë me dhurim** plotësohet me shumën e pagesave që kryhen për kalimin e të drejtës së pronësisë me dhurim.
16. **Në rubrikat [8/1] .... deri ne rubriken [19/1]** shënohen shumat e tatimit të mbajtur në burim përkatesisht për pagesat e listuara në rubrikat **[** 8] deri në [19] duke i shumëzuar me % e vlerës së tatueshme. Në rastet kur Republika e Shqipërisë ka lidhur marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, % shkallës për llogaritjen e tatimit do të merret sipas përcaktimeve në këto marrëveshje.
17. **Në rubrikën [20] Totali i tatimit të Ilogaritur dhe të mbajtur në burim shënohet shuma e rubrikave** [8/1] + [9/1] + [10/1] + [11/1] + [12/1] + [13/1] + [14/1] + [15/1] + [16/1] + [17/1]+ [18/1]+ [19/1].
18. **Rubrika [21] Totali për t'u paguar** është shuma e tatimit në burim i detyruar për tu paguar i njëjtë me rubrikën 20, pra [20] = [21].

URDHËR
Nr. 106, datë 20.3.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike", të ndryshuar

URDHËROJ:

I. Delegimin e kompetencave të titullarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Rudin Baqli, për çështjet e mëposhtme:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, prë të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e tij si nëpunës autorizues në funksiuon të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

II. Këto kompetenca ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

III. Delegimi i kompetencave, mbaron me revokimin e këtij urdhri, si dhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

IV. Ngarkohet prë zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, z. Rudin Baqli, si dhe administrata e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Naureda Llagami

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 588 lekë